Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

**MENDIM**

**Data e miratimit: 14 mars 2014**

**Lëndët nr. 63/09, 64/09, 65/09, 66/09, 109/09, 113/09, 162/09, 300/09 dhe 301/09**

**Serbolub MITIQ, SllaviMITIQ, Smiljana GJEKIQ, Spasena MARKOVIQ, Todor MARKOVIQ, Stanomir JOVANOVIQ, Marija JOVANOVIQ**

**kundër**

**UNMIK-ut**

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 14 mars 2014,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Marek Nowicki, kryesues
Christine Chinkin
Françoise Tulkens

Të ndihmuar nga

Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në pajtim me rregullën 13 § 2 të Rregullores së punës, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

## I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesat e z. Serbolub Mitiq (lëndët nr. 63/09 dhe 64/09) dhe ankesat e Sllavi Mitiq (lëndët nr. 65/09 dhe 66/09), janë paraqitur më 15 prill 2009 dhe janë regjistruar më 30 prill 2009. Ankesa e znj. Smiljana Gjekiq (lënda nr. 109/09) është paraqitur më 3 mars 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009. Ankesa e znj. Spasena Markoviq (lënda nr. 113/09) është

paraqitur më 4 prill 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009. Ankesa e z. Todor Markoviq (lënda nr. 162/09) është paraqitur më 7 prill 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009. Ankesa e z. Stanomir Jovanoviq (lënda nr. 300/09) është paraqitur dhe është regjistruar më 22 qershor 2009. Ankesa e znj. Marija Jovanoviq (lënda nr. 301/09) është paraqitur dhe është regjistruar më 18 qershor 2009.

2. Më 24 korrik 2009, Paneli e njoftoi për ankesat nr. 63/09, 64/09, 65/09 dhe 66/09, si raste individuale, Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP)[1], lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesave. PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut më 5 gusht 2009.

3. Më 24 tetor 2009, Paneli vendosi t'i bashkojë lëndët nr. 63/09 dhe 64/09 me lëndët nr. 65/09 dhe 66/09 në pajtim me rregullën 20 të Rregullores së vet të punës.

4. Më 9 dhjetor 2009 dhe më 23 dhjetor 2009, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesit për lëndët nr. 109/09 dhe 162/09.

5. Më 18 dhjetor 2009, Paneli kërkoi nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) informata që kanë të bëjnë me 43 ankesa në lidhje me personat e zhdukur të dorëzuara para Panelit, duke përfshirë ankesën e znj. Smiljana Gjekiq (lënda nr.109/09).

6. Më 13 janar 2010, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesja për lëndën nr. 113/09.

7. Më 23 mars 2010,EULEX-i ofroi një përgjigje ndaj kërkesës së Panelit të 18 dhjetorit të vitit 2009.

8. Më 21 prill 2010, Paneli kërkoi informata shtesë në lidhje me lëndët nr. 63/09, 64/09, 65/09 dhe 66/09.

9. Më 12 maj 2010, Paneli përsëriti kërkesën e vet për informata shtesë nga ankuesi për lëndën nr. 162/09. Përgjigja e ankuesit u pranua më 20 maj 2010.

10. Më 9 shtator 2010, Paneli vendosi t'i bashkojë lëndët tashmë të bashkuara numër 63/09, 64/09, 65/09 dhe 66/09 me lëndën nr. 109/09. Po të njëjtën ditë, Paneli vendosi t'i bashkojë lëndët nr. 113/09 dhe 162/09.

11. Më 6 tetor 2010, Paneli përsëriti kërkesën e vet për informata shtesë nga ankuesit për lëndët nr. 63/09, 64/09, 65/09, 66/09, 109/09 dhe 113/09.

12. Më 28 tetor 2010, Paneli pranoi përgjigjen e ankueses në lidhje me lëndën nr. 109/09.

13. Më 11 nëntor 2010, Paneli pranoi informata shtesë nga ankuesi për lëndët nr. 63/09 dhe 64/09.

14. Më 8 dhjetor 2010, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesi për lëndën 300/09 dhe nga ankuesja për lëndën nr. 301/09. Paneli pranoi përgjigjen e ankueses në lidhje me lëndën nr. 301/09 më 20 janar 2011.

[1]Një listë me shkurtesa dhe akronime që përmban teksti mund të gjendet në Shtojcën e bashkëngjitur.

15. Më 4 mars 2011, Paneli e njoftoi PSSP-në për lëndën nr. 109/09 dhe e rinjoftoi atë për lëndët nr. 63/09, 64/09, 65/09 dhe 66/09, pas vendimit të vet për t'i bashkuar lëndët, dhe pas pranimit të informatave shtesë nga ankuesi për lëndët nr. 63/09 dhe 64/09. PSSP-ja dha përgjigjen e vet më 31 maj 2011.

16. Më 19 prill 2011, Paneli ia përcolli PSSP-së informatat shtesë në lidhje me lëndën nr. 109/09.

17. Më 25 korrik 2011, Paneli e njoftoi PSSP-në për lëndën nr. 301/09 lidhur me dhënien e komenteve të tij mbi pranueshmërinë e ankesës. Më 30 shtator 2011, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

18. Më 22 tetor 2011, Paneli vendosi t'i bashkojë lëndët tashmë të bashkuara nr. 63/09, 64/09-65/09, 66/09, 109/09 me lëndët e bashkuara nr. 113/09, 162/09,dhe gjithashtu me lëndët nr. 300/09 dhe 301/09.

19. Më 31 tetor 2011, Paneli e rinjoftoi PSSP-në për lëndët nr. 63/09, 64/09, 65/09, 66/09, 109/09 dhe 301/09 dhe e njoftoi për lëndët nr. 113/09, 162/09 dhe 300/09 për komente mbi pranueshmërinë.

20. PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut më 15 dhjetor 2011.

21. Më 10 maj 2012, Paneli i shpalli ankesat të pranueshme.

22. Më 15 maj 2012, Paneli e njoftoi PSSP-në për vendimin mbi pranueshmërinë, duke kërkuar observimet e UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e ankesave dhe gjithashtu kopjet e dosjeve hetimore relevante për rastin.

23. Më10 dhjetor 2013, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

24. Më 21 shkurt 2014, Paneli i kërkoi UNMIK-ut që të konfirmojë nëse hapja e dosjeve që kanë të bëjnë me lëndën mund të konsiderohet përfundimtare. Po të njëjtën ditë, UNMIK-u dha përgjigjen e vet.

25. Më 10 mars 2014, Paneli pranoi informata shtesë nga ankuesi për lëndën nr. 300/09.

## II. FAKTET

### A. Historiku i përgjithshëm[2]

[2]Referencat e nxjerra nga Paneli për të përcaktuar historikun e përgjithshëm përfshijnë: OSBE, "Siç është parë dhe treguar", vëll. 1 (tetor 1998 – qershor 1999) dhe vëll. II (14 qershor – 31 tetor 1999); raportet tremujore të Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë; Raportet vjetore të Policisë së UNMIK-ut (2000, 2001); Qendra për të Drejtën Humanitare, "Rrëmbimet dhe zhdukjet e joshqiptarëve në Kosovë" (2001); Qendra për të Drejtën Humanitare, "Libër kujtimi për Kosovën" (htpp://www.kosovomemorybook.org); Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, Raport i Aktivitetit 2002-2004; Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Behrami dhe Behrami kundër Francës* dhe *Saramati kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë*, me numrat 71412/01 dhe 78166/01, vendimi i datës 2 maj 2007; Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, "Situata në Kosovë: Një vlerësim" (2010); të dhënat e

26. Ngjarjet në fjalë ndodhën në territorin e Kosovës pas krijimit të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-ut), në qershor të vitit 1999.

27. Konflikti i armatosur gjatë vitit 1998 dhe 1999, ndërmjet forcave serbe në njërën anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe grupeve të tjera të armatosura të shqiptarëve të Kosovës në anën tjetër, është mirë i dokumentuar. Pas dështimit të përpjekjeve ndërkombëtare për të zgjidhur konfliktin, më 23 mars 1999, Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) shpalli fillimin e sulmeve ajrore kundër Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ-së). Sulmet ajrore filluan më 24 mars 1999 dhe përfunduan më 8 qershor 1999, kur RFJ-ja u pajtua t'i tërheqë forcat e veta nga Kosova. Më 9 qershor 1999, Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (KFOR), RFJ-ja dhe Republika e Serbisë nënshkruan një "Marrëveshje Tekniko-Ushtarake" përmes së cilës u pajtuan mbi tërheqjen e RFJ-së nga Kosova dhe praninë e një force ndërkombëtare të sigurisë, pas miratimit të rezolutës përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

28. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1244 (1999). Duke vepruar sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Këshilli i Sigurimit i OKB-së mori vendim për vendosjen e pranisë ndërkombëtare të sigurisë dhe civile-përkatësisht të KFOR-it dhe UNMIK-ut, në territorin e Kosovës. Në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr. 1244 (1999), OKB-ja u ngarkua me kompetenca të plota legjislative dhe ekzekutive. KFOR-i u ngarkua për krijimin e "një ambienti të sigurt, në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në shtëpi të sigurt" dhe përkohësisht të sigurojë "rendin dhe sigurinë publike", derisa prania ndërkombëtare civile të mund të marrë përsipër përgjegjësinë për këtë detyrë. UNMIK-u përbëhej nga katër komponentë apo shtylla kryesore të udhëhequra nga OKB-ja (administrata civile), Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (ndihma humanitare, e cila u hoq në qershorin e vitit 2000), OSBE-ja (ndërtimi institucional) dhe BE-ja (rindërtimi dhe zhvillimi ekonomik). Secila shtyllë u vendos nën autoritetin e PSSP-së. Përmes Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999), UNMIK-ut i jepet mandati që t'i "promovojë dhe mbrojë të drejtat e njeriut" në Kosovë në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

29. Vlerësimet lidhur me ndikimin e konfliktit në shpërnguljen e popullatës shqiptare të Kosovës sillen prej përafërsisht 800,000 deri 1.45 milion. Pas miratimit të Rezolutës 1244 (1999), shumica e shqiptarëve të Kosovës, të cilët ishin larguar, apo ishin dëbuar me forcë nga shtëpitë e tyre nga forcat serbe gjatë konfliktit, u kthyen në Kosovë.

30. Në ndërkohë, pjesëtarët e komunitetit joshqiptar-kryesisht serbët, dhe jo vetëm ata, por edhe romët dhe myslimanët sllavë si dhe shqiptarët e Kosovës të dyshuar për bashkëpunim me autoritetet serbe, u bënë shënjestër e sulmeve shumë të përhapura të grupeve të armatosura të shqiptarëve të Kosovës. Vlerësimet e tanishme lidhur me numrin e serbëve të Kosovës të zhvendosur sillen përafërsisht prej 200,000 deri 210,000. Ndërsa shumica e serbëve të Kosovës dhe joshqiptarët e tjerë të Kosovës u larguan në Serbi dhe në vendet

---

publikuara nga Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë, (në dispozicion në www.unhchr.org) dhe nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar (në dispozicion në http://familylinks.icrc.org/kosovo/en).

fqinje, ata që mbetën prapa u bënë viktima të vrasjeve sistematike, rrëmbimeve, mbajtjeve arbitrare, dhunës seksuale dhe asaj të bazuar në gjini, rrahjeve dhe frikësimit.

31. Megjithëse shifrat mbesin kontestuese, vlerësohet që më shumë se 15,000 vdekje apo zhdukje ndodhën si pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të Kosovës dhe gjatë tij (1998-2000). Më shumë se 3,000 shqiptarë etnikë dhe rreth 800 serbë, romë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera minoritare u zhdukën gjatë kësaj periudhe. Për më shumë se gjysmën e personave të zhdukur janë gjetur dhe identifikuar mbetjet e tyre mortore deri në fund të vitit 2010, ndërsa 1,766 gjenden ende si të zhdukur në listën e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), sipas të dhënave të muajit tetor 2012.

32. Prej korrikut të vitit 1999, si pjesë e përpjekjeve për të rivendosur zbatimin e ligjit në Kosovë brenda kornizës së sundimit të ligjit, PSSP-ja u kërkoi vendeve anëtare të OKB-së që të mbështesin vendosjen brenda komponentit civil të UNMIK-ut, të policëve ndërkombëtarë prej 4,718 vetash. Policia e UNMIK-ut u ngarkua me këshillimin e KFOR-it mbi çështjet policore, derisa ata vetë të kenë numër të mjaftueshëm për të marrë krejt përgjegjësinë për zbatimin e ligjit dhe të punojnë drejt zhvillimit të Shërbimit Policor të Kosovës. Deri në shtator të vitit 1999, përafërsisht 1,100 policë ndërkombëtarë u vendosën në Kosovë në kuadër të UNMIK-ut.

33. Deri në dhjetor të vitit 2000, vendosja e Policisë së UNMIK-ut pothuajse përfundoi me 4,400 policë nga 53 vende të ndryshme dhe UNMIK-u kishte marrë primatin sa i përket përgjegjësisë për zbatimin e ligjit në të gjitha rajonet e Kosovës, përveç Mitrovicës. Sipas Raportit vjetor të Policisë së UNMIK-ut për vitin 2000, atyre u janë raportuar 351 rrëmbime, 675 vrasje dhe 115 dhunime për periudhën qershor 1999 - dhjetor 2000.

34. Për shkak të kolapsit të administrimit të drejtësisë në Kosovë, UNMIK-u në qershor të vitit 1999 themeloi një Sistem emergjent të drejtësisë. Ai përbëhej nga një numër i kufizuar gjyqtarësh dhe prokurorësh vendorë dhe ishte operacional derisa sistemi i rregullt i drejtësisë u bë operacional në janar të vitit 2000. Në shkurt të vitit 2000, UNMIK-u autorizoi emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, fillimisht në rajonin e Mitrovicës dhe më vonë në gjithë Kosovën, për të forcuar sistemin lokal të drejtësisë dhe për të garantuar paanësinë. Prej tetorit të vitit 2002, sistemi lokal i drejtësisë përbëhej prej 341 gjyqtarëve dhe prokurorëve vendorë dhe 24 ndërkombëtarë. Në janar të vitit 2003, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, duke i raportuar Këshillit të Sigurimit për zbatimin e Rezolutës 1244 (1999), sistemin e policisë dhe drejtësisë në Kosovë në atë kohë e definoi si sistem që "funksionon mirë" dhe "i qëndrueshëm".

35. Në korrik të vitit 1999, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së i raportoi Këshillit të Sigurimit që UNMIK-u tashmë e konsideronte çështjen e personave të zhdukur si një shqetësim veçanërisht të madh për të drejtat e njeriut në Kosovë. Në muajin nëntor të vitit 1999, u krijua Njësiti për Personat e Zhdukur (NJPZH) brenda Policisë së UNMIK-ut, me mandat të hetojë vendndodhjen e mundshme të personave të zhdukur dhe/apo varrezave. NJPZH-ja, së bashku me Njësitin Qendror për Hetim të Krimit (NJQHK) të Policisë së UNMIK-ut, dhe më vonë Njësiti për Hetimin e Krimeve të Luftës (NJHKL), ishin përgjegjëse për aspektet penale të rasteve të personave të zhdukur në Kosovë. Në maj të vitit 2000, u krijua Komisioni për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave (KGJIV), i udhëhequr nga UNMIK-u, për të gjetur, identifikuar dhe dorëzuar mbetjet mortore. Prej qershorit të vitit 2002, Zyra e sapoformuar për personat e zhdukur dhe mjekësi ligjore (ZPZHML) në Departamentin e

Drejtësisë të UNMIK-ut (DDU), u bë autoriteti i vetëm i mandatuar për të përcaktuar vendndodhjen e personave të zhdukur, t'i identifikojë mbetjet e tyre mortore dhe t'ua kthejë ato familjes së të zhdukurit. Duke filluar nga viti 2001, në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) ndërmjet UNMIK-ut dhe Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur me seli në Sarajevë (KNPZH), i plotësuar nga një marrëveshje tjetër në vitin 2003, identifikimi i mbetjeve mortore u krye nga KNPZH-ja përmes testit të ADN-së.

36. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me policinë dhe drejtësinë në Kosovë përfundoi me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), i cili mori kontrollin e plotë operacional në fushën e sundimit të ligjit, pasi që kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), nxori Deklaratën që mirëpriste angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

37. Po të njëjtën ditë, UNMIK-u dhe EULEX-i nënshkruan një MM mbi modalitetet dhe të drejtat dhe obligimet përkatëse që dalin nga transferimi prej UNMIK-ut tek EULEX-i, i lëndëve dhe dosjeve përkatëse të cilat përfshinin hetimet, ndjekjet penale në vijim dhe aktivitetet e tjera të ndërmarra nga prokurorët ndërkombëtarë të UNMIK-ut. Menjëherë pas kësaj, marrëveshje të ngjashme u nënshkruan në lidhje me dosjet e mbajtura nga gjyqtarët ndërkombëtarë dhe Policia e UNMIK-ut. Të gjitha marrëveshjet obliguan EULEX-in të sigurojë qasje nga UNMIK-u në dokumentet që ndërlidhen me veprimet që autoritetet e UNMIK-ut i kanë ndërmarrë më parë. Në periudhën 9 dhjetor 2008 deri më 30 mars 2009, të gjitha dosjet me lëndë penale të mbajtura nga DD i UNMIK-ut dhe Policia e UNMIK-ut, iu dorëzuan EULEX-it.

**B. Rrethanat që ndërlidhen me vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq në fshatin Mushtisht, qershor 1999**

38. Ankuesit deklarojnë se anëtarët e tyre të familjes, znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq, z. Radisllav Jovanoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq, ishin në mesin e përafërsisht 15-20 serbëve, të cilët mbetën në fshatin Mushtisht, Komuna e Suharekës, pas arritjes së KFOR-it në qershor të vitit 1999. Ankuesit deklarojnë se të afërmit e tyre u zhdukën në qershor të vitit 1999 gjatë një sulmi të UÇK-së në këtë fshat. Vendndodhjet e të gjithë të të afërmve të tyre janë të panjohura deri më tani.

*Zhdukja e znj. Jovanka Mitiq dhe z. Stanisllav Mitiq (lëndët nr. 63/09, 64/09, 65/09, 66/09, 109/09)*

39. Ankuesi i parë është djali i znj. Jovanka Mitiq (lënda nr. 63/09) dhe i z. Stanisllav Mitiq (lënda nr. 64/09). Ankuesi i dytë është gjithashtu djali i znj. dhe i z. Mitiq (lënda nr. 65/09 dhe 66/09). Ankuesja e tretë është vajza e znj. dhe e z. Mitiq (lënda nr. 109/09).

40. Ankuesit në lëndët nr. 63-66/09 dhe 109/09 deklarojnë se ata nuk ishin të pranishëm në fshat kur znj. Jovanka Mitiq dhe z. Stanisllav Mitiq u zhdukën dhe se informatat rreth ngjarjeve relevante u janë dhënë atyre nga gjyshja e tyre, T.J.,e cila ishte rreth 90-vjeçe në kohën e ngjarjeve.

41. Ankuesi i parë deklaron se ai i pa prindërit e tij për herë të fundit më 13 qershor 1999, derisa po nisej me familjen e tij për të shkuar në Serbi, për arsye sigurie. Ai gjithashtu deklaron se prindërit e tij mbetën prapa për të mbrojtur shtëpinë dhe pronën e tyre, me besim se askush nuk do t'u bëjë keq pleqve sikur ata. Ai gjithashtu deklaron se disa fqinjë, të cilët fillimisht mbetën në Mushtisht, iu bashkuan atyre një ditë më vonë në karvanin për në Serbi. Fqinjët e tyre thanë se ata "mezi ia dolën të mbijetojnë" gjatë natës së fundit të kaluar në Mushtisht dhe se pak serbë që akoma ishin atje, në mesin e tyre T.J., znj. dhe z. Mitiq, z. Radisllav Jovanoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq, nuk kishin mjete për ta braktisur fshatin.

42. Ankuesit deklarojnë se sipas rrëfimit të T.J., më 11 qershor 1999 apo më vonë, një grup i personave të panjohur me armë dhe të veshur në uniforma të UÇK-së, arritën në fshat. Ata vranë djalin e T.J., z. Radisllav Jovanoviq (shih§§ 46-47 më poshtë) para syve tësaj. Pas vrasjes së djalit të saj, T.J. deshi të shkojë drejt shtëpisë së vajzës së saj, znj. Jovanka Mitiq, dhe dhëndrrit të saj z. Stanisllav Mitiq, për të verifikuar nëse ata ishin akoma gjallë, por ajo kurrë nuk arriti në shtëpinë e tyre, pasi ajo ishte dërguar nga persona të panjohur në Stacionin e policisë në afërsi dhe ishte mbajtur atje nga "shqiptarët" për tri ditë. Gjatë gjithë kësaj periudhe, një mjek i quajtur "Sali" e vizitonte atë dhe i sillte ushqim. Kur ajo u lirua dhe ishte rrugës duke u kthyer në shtëpinë e saj, fëmijët e gjuanin me gurë dhe e pështynin atë. Ajo u kthye në shtëpinë e saj dhe kaloi gjashtë ditë duke fjetur në hangar me kafshët e saj, ndërsa dy fqinjët shqiptarë të përmendur me emër i sollën asaj ushqim. Fqinjët e njëjtë, në një përpjekje për ta mbrojtur atë, informuan ushtarët e KFOR-it për të. Ata e sollën atë në shkollën teologjike për priftnë Prizren. Ankuesja në lëndën nr. 109/09 deklaron se T.J. gjithashtu ishte dëshmitare e vrasjes në duar të UÇK-së të fqinjessë saj S.ZH. dhe vajzës trevjeçare të S.ZH.

43. Ankuesit deklarojnë se zhdukja e znj. dhe z. Mitiq iu raportua KNKK-së, Kryqit të Kuq Jugosllav, KFOR-it, UNMIK-ut, Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë dhe Zyrës së prokurorit ndërkombëtar në Prishtinë. Ankuesi në lëndën nr. 162/09 thotë se ai i raportoi vetëm KNKK-së dhe nuk kishte ndonjë kontakt me UNMIK-un.

44. Ankuesi në lëndët 63/09 dhe 64/09 deklaron se përmes shërbimeve të KNKK-së për kërkim, ai kontaktoi fqinjët shqiptarë të përmendur në § 42më lart, me shpresë se do të merrte më shumë informata nga ta; megjithatë, ata deklaruan se kishin shkuar në Shqipëri dhe, kur ata u kthyen, nuk e gjetën asnjë nga ata që kishin mbetur në fshat. Ai deklaron se ai gjithashtu "u paraqit për test të ADN-së", pa specifikuar kur apo në cilin institucion. Për më tepër, në një datë të paspecifikuar, ai shkoi në Graçanicë në një ekspozitë të rrobave që u takonin personave të zhdukur, por ai nuk mund të njihte ndonjë gjësend si të prindërve të tij.

45. Ankuesit i paraqitën KNKK-së një kërkesë për kërkimin e znj. dhe z. Mitiq, duke treguar 13 qershorin e vitit 1999 si datën e zhdukjes së tyre. Emrat e tyre gjithashtu gjenden edhe në listën e personave të zhdukur që KNKK ia dërgoi Policisë së UNMIK-ut më 12 tetor 2001, për të cilët KNKK kishte mbledhur të dhëna ante-mortem në Serbi. Emrat e z. dhe znj. Mitiq janë gjithashtu të përfshirë në bazat e të dhënave të përpiluara nga ZPZHML e UNMIK-ut dhe KNPZH; në shënimet në lidhje me znj. dhe z. Mitiq në bazën[3] e të dhënave

[3]Baza e të dhënave e KNPZH-së është në dispozicion në: http://www.ic-mp.org/fdmsweb/index.php?w=mp_details&l=en(e qasur më 12 mars 2014).

‘online’ të KNPZH-së në pjesët relevante thuhet: “Janë mbledhur mostra të mjaftueshme për referencë” dhe “nuk është gjetur përshtatje e ADN-së”.

*Vrasja e z. Radisllav Jovanoviq (lënda nr. 300/09)*

46. Ankuesi i gjashtë është djali i z. Radisllav Jovanoviq. Në ankesën e tij për Panelin, ankuesi deklaroi se babai i tij “ishte rrëmbyer në Mushtisht më 13 qershor 1999”, derisa ky i fundit ishte me nënën e tij, T.J. Në parashtresat e mëtejme para Panelit, ankuesi gjithashtu iu referua dëshmisë së T.J., sipas së cilës z. Radisllav Jovanoviq ishte vrarë para saj nga pjesëtarët e UÇK-së (shih § 42 më lart).

47. Ankuesi gjithashtu konfirmoi se mbetjet mortore të babait të tij nuk janë gjetur deri më tani. Në të vërtetë, një kërkesë e KNKK-së për kërkimin e z. Radisllav Jovanoviq, që tregon 14 qershorin e vitit 1999 si datën e zhdukjes së tij, mbetet e hapur. Emri i z. Radisllav Jovanoviq gjithashtu gjendet në bazën e të dhënave të përpiluar nga KNPZH; në shënimin në lidhje me z. Radisllav Jovanoviq në bazën e të dhënave ‘online” të KNPZH-së në pjesët relevante thuhet “Janë mbledhur mostra të mjaftueshme për referencë” dhe “nuk është gjetur përshtatje e ADN-së”.

*Zhdukja e z. Stanisllav Markoviq (lëndët nr. 113/09 dhe 162/09)*

48. Ankuesja e katërt është gruaja e z. Stanisllav Markoviq (lënda nr. 113/09). Ankuesi i pestë është djali i z. Stanisllav Markoviq (lënda nr. 162/09).

49. Ankuesit deklarojnë se më 11 qershor 1999, ditën kur shumica e “fshatarëve” serbë filluan ta braktisin Mushtishtin duke u frikësuar nga “terroristët shqiptarë”, z. Stanisllav Markoviq doli nga fshati për ta dërguar bagëtinë e tij në kullotë. Që nga ajo kohë, vendndodhja e tij është e panjohur.

50. Ankuesi në lëndën nr. 162/09 deklaron se “18 fshatarët” e Mushtishtit ishin rrëmbyer nga UÇK-ja ditën e njëjtë me të babait të tij. Në atë kohë, ushtarët e KFOR-it tanimë kishin hyrë në Komunën e Suharekës. Ai deklaron se familja e tij pranoi rrëfime të ndryshme rreth zhdukjes së babait të tij. Sipas rrëfimit të T.J. (shih§ 40më lart), ai ishte vrarë më 20 apo 21 qershor 1999: ajo dëgjoi qentë e z. Stanisllav Markoviq që lehnin dhe pastaj një shkrehje të armës së zjarrit dhe pastaj asgjë tjetër. Sipas një rrëfimi tjetër, ai ishte vetë në Suharekë kur ishte rrëmbyer. Sipas rrëfimit të tretë, për të cilin nuk është specifikuar burimi, ai ishte rrëmbyer dhe dërguar në fshatin “Gërkovc” dhe ishte detyruar të punojë si bari atje.

51. Ankuesit deklarojnë se ata ia raportuan zhdukjen KNKK-së, Kryqit të Kuq Jugosllav, Policisë së UNMIK-ut dhe prokurorit ndërkombëtar (PN) në Prishtinë; megjithatë ata “nuk morën ndonjë përgjigje”. Ankuesi në lëndën nr. 162/09 deklaron se, së paku pesë herë, ai shkoi në fshatin Mushtisht për t’i pyetur fqinjët rreth babait të tij, por thuhet se ata nuk dinin asgjë.

52. Ankuesit paraqitën një kërkesë të KNKK-së për kërkimin e z. Stanisllav Markoviq, që tregon 12 qershorin e vitit 1999 si datën e zhdukjes së tij. Emri i tij gjithashtu gjendet edhe në dy lista të personave të zhdukur që KNKK ia dërgoi Policisë së UNMIK-ut më 12 tetor 2001 dhe 11 shkurt 2002, për të cilët KNKK kishte mbledhur të dhëna ante-mortem. Emri i z. Markoviq është gjithashtu i përfshirë në bazat e të dhënave të përpiluara nga ZPZHML e UNMIK-ut dhe KNPZH; në shënimin në lidhje me z. Markoviq në bazën e të dhënave 'online' të KNPZH-së[4], në pjesët relevant thuhet"Janë mbledhur mostra të mjaftueshme për referencë" dhe "nuk është gjetur përshtatje e ADN-së".

*Zhdukja e z. Bozhidar Jovanoviq (lënda nr. 301/09)*

53. Ankuesja e shtatë është gruaja e z. Bozhidar Jovanoviq.

54. Ankuesja deklaron se burri i saj, z. Bozhidar Jovanoviq, ishte rrëmbyer nga persona të panjohur më 11 qershor 1999. Ajo deklaron se ai "qëndroi në shtëpi të vet në Mushtisht, pasi ai i besoi Misionit të OKB-së sa i përket mbrojtjes së banorëve të Kosovës dhe Metohisë".

55. Një kërkesë e KNKK-së për kërkimin e z. Bozhidar Jovanoviq mbetet e hapur. Emri i tij gjendet në bazën e të dhënave të ZPZHML-së dhe në një listë të personave të zhdukur që KNKK ia dërgoi Policisë së UNMIK-ut më 11 shkurt 2002, për të cilët KNKK kishte mbledhur të dhëna ante-mortem, dhe gjithashtu në bazat e të dhënave të përpiluara nga ZPZHML e UNMIK-ut dhe KNPZH. Në shënimin në lidhje me z. Jovanoviq në bazën e të dhënave 'online' të KNPZH-së[5], në pjesët relevante thuhet "Janë mbledhur mostra të mjaftueshme për referencë" dhe "nuk është gjetur përshtatje e ADN-së".

*Raporti i Qendrës për të Drejtën Humanitare për ngjarjet në Mushtisht*

56. Sipas raportit të Qendrës për të Drejtën Humanitare, i cili bazohet në deklaratat e dëshmitarëve, shumica e fshatarëve u larguan nga Mushtishti menjëherë pas tërheqjes së Armatës jugosllave dhe Policisë serbe nga Kosova, ndërsa vetëm 25 sish, kryesisht persona më të vjetër mbetën në fshat. Pasi fshati nuk kishte telefon, anëtarët e familjes të atyre që kishin mbetur prapa nuk mund t'i kontaktonin ata. Prifti lokal, F.I., i informoi familjet se ai i kishte parë serbët nga Mushtishti për herën e fundit më 15 qershor 1999. Pak ditë më vonë, fshati u zu nga UÇK-ja dhe atij i ishte parandaluar të shkojë atje; megjithatë, atij i kishin treguar njerëzit që kishin udhëtuar më vonë përmes Mushtishtit se vendi ishte i banuar.

57. Qendra për të Drejtën Humanitare i referohet gjithashtu dëshmisë së T.J. (shih§ 40më lart), e cila thuhet se ishte rrëmbyer në Mushtisht nga UÇK-ja, më 13 qershor 1999 dhe ishte liruar menjëherë më vonë. T.J. i tha nipit të saj se UÇK-ja e kishte "djegur djalin e saj të gjallë në shtëpinë e tij" (lënda nr. 300/09), e kishte vrarë znj. "Jovana" Mitiq, z. Stanisllav Mitiq (lëndët nr. 63-66/09, 109/09), z. Bozha Mitiq, dhe gjithashtu S.ZH.dhe fëmijën e saj trevjeçar. Në raportin e Qendrës për të Drejtën Humanitare, z. Bozhidar Jovanoviq (lënda

[4]Baza e të dhënave e KNPZH-së është në dispozicion në: http://www.ic-mp.org/fdmsweb/index.php?w=mp_details&l=en (e qasur më 22 mars 2014).
[5]Baza e të dhënave e KNPZH-së është në dispozicion në: http://www.ic-mp.org/fdmsweb/index.php?w=mp_details&l=en (e qasur më 12 mars 2014).

nr. 301/09) paraqitet si i zhdukur që nga 15 qershori i vitit 1999, por nuk është bërë asnjë referim për z. Stanisllav Markoviq (lëndët nr. 113/09 dhe 162/09).

## C. Hetimi

58. Në rastin aktual, Paneli pranoi nga UNMIK-u dokumentet hetimore të mbajtura më parë nga ZPZHML e UNMIK-ut dhe NJHKL e Policisë së UNMIK-ut. Paneli thekson se UNMIK-u ka konfirmuar se të gjitha dokumentet në dispozicion janë ofruar.

59. Për sa i përket publikimit të informatave që përmbajnë dosjet, Paneli rikujton që UNMIK-u i ka vënë në dispozicion dosjet për hetim për t'u shqyrtuar nga Paneli nën një zotim për konfidencialitet. Në lidhje me këtë, Paneli duhet të qartësojë që megjithëse vlerësimi i dosjes aktuale rrjedh nga një shqyrtim i plotë i dokumentacionit në dispozicion, vetëm informata të limituara që ekzistojnë aty janë publikuar. Prandaj, një përmbledhje e hapave të ndërmarrë nga autoritetet e hetuesisë është dhënë në paragrafët në vijim.

60. Në dosjen hetimore zbulohet se hetimet për vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq, ishin kryer në kohë të ndryshme nga njësitë e ndryshme hetimore të Policisë së UNMIK-ut, si në vijim.

*Për zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq dhe z. Stanisllav Mitiq*

61. Lëndët për persona të zhdukur të NJPZH-së së Policisë së UNMIK-ut lidhur me zhdukjen e z. Stanisllav Mitiq dhe znj. Jovanka Mitiq, u hapën me numrin 2002-000208 dhe 2002-000249.

62. Dosja hetimore përfshinë formularët e NJPZH-së për identifikim të viktimës për z. Stanisllav Mitiq dhe znj. Jovanka Mitiq. Të bashkëngjitura janë formularët me informata ante-mortem për secilin nga personat e zhdukur, siç ishin mbledhur më parë nga KNKK në Beograd, të cilët nuk kanë ndonjë datë. Në këta formularë thuhet se gruaja dhe burri u zhdukën së bashku; se djali i tyre, ankuesi Sllavi Mitiq, i la ata në Mushtisht më 23 qershor 1999; dhe se, që nga ajo ditë vendndodhjet e tyre mbeten të panjohura. Në formularin me informata ante-mortem është përfshirë adresa e plotë, duke përfshirë numrin e tij të telefonit, të ankuesit të dytë z. Sllavi Mitiq. Formulari me informata ante-mortem për znj. Jovanka Mitiq përfshin gjithashtu detajet e plota të kontaktit, duke përfshirë një adresë dhe numrin e telefonit në Serbi për T.J. (shih § 40 më lart), e cila është nëna e personit të zhdukur.

63. Shënimet në raportin për vazhdim të rastit të NJPZH-së në lidhje me lëndën nr. 2002-000208 tregojnë se të dhënat e plota ante-mortem për z. Stanisllav Mitiq, siç janë marrë nga KNKK-ja, janë futur në bazën e të dhënave të NJPZH-së në periudhën mes 29 mars 2002 dhe 8 nëntor 2002. Në një raport për vazhdim të rastit të NJPZH-së në lidhje me lëndën nr. 2002-000249 thuhet se të dhënat ante-mortem për znj. Jovanka Mitiq, siç janë transmetuar nga KNKK-ja, janë futur në bazën e të dhënave të NJPZH-së në periudhën mes 4 prillit dhe 19 dhjetorit 2002.

64. Dosja hetimore gjithashtu përmban dy raporte, pothuajse identike, të hetimit ante-mortem të NJPZH-së së Policisë së UNMIK-ut, një në lidhje me zhdukjen e z. Stanisllav Mitiq (nr.

1154/INV/04, i datës 22 dhjetor 2004 – 24 dhjetor 2004) dhe tjetri në lidhje me zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq (nr. 0989/INV/04, i datës 9 dhjetor – 24 dhjetor 2004). Në të dy raportet thuhet se z. dhe znj. Mitiq u zhdukën më 23 qershor 1999 nga Mushtishti; se rasti i ishte raportuar KNKK-së në Beograd; dhe se dosja e NJPZH-së ishe hapur në vitin 2002. Në rubrikën e raportit "Përmbledhje e informatave të marra deri më tani për të filluar hetimin", thuhet "nuk ka të dhëna të mjaftueshme në formularin për identifikim të viktimës". Në rubrikën "Hetimi i mëtejmë" të raportit thuhet se hetuesit kishin provuar të kontaktojnë të afërmin e viktimës, por "kjo nuk ishte e mundshme, pasi personat nuk ishin në dispozicion madje as përmes telefonit". Në raport gjithashtu thuhet "nuk ka dëshmitarë në dispozicion për këtë rast për momentin" dhe, në format të shkronjave të spikatura me të zezë, "ky rast ka nevojë për më shumë hetim". Përfundimi i hetuesit ishe se rastet duhet të mbesin "në zhvillim e sipër" në kuadër të NJHKL-së. Në raporte tregohet se ato ishin kontrolluar dhe aprovuar nga udhëheqësi i hetimit i NJPZH-së.

65. Dosja hetimore gjithashtu përfshin një raport të shqyrtimit të analizës së rastit të NJHKL-së së UNMIK-ut, i datës 15 shtator 2008, lidhur me zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq (lënda e NJPZH-së nr. 2002-000249). Në rubrikat "Prioriteti i rastit", "Statusi", "Arsyeja", të raportit thuhet, si në vijim, "I ulët", "Në zhvillim e sipër","Në pritje të informatave tjera". Në rubrikën "Komentet e zyrtarit shqyrtues", të raportit thuhet "Nuk ka të dhëna të mjaftueshme në dosje lidhur me identifikimin e PZH-së. Rasti mund të mbahet në zhvillim e sipër deri tek informatat e tjera". Në rubrikën lidhur me "Mbledhjen e mostrave të gjakut për ADN", thuhet se nuk kishte informata nëse anëtarët e familjes i kishin dhënë mostrat e gjakut për qëllim të identifikimit.

*Për vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq*

66. Dosja hetimore përmban një "Formular shtesë/vazhdues" të Policisë së UNMIK-ut, i datës 6 dhjetor 2001, lidhur me vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq. Në raport thuhet se, më 5 dhjetor 2001, një hetues i Policisë së UNMIK-ut vizitoi në Prizren priftin ortodoks A.[N.], i cili deklaroi se ai ishte në kontakt me një person, T.J., e cila mund të ishte dëshmitare në një rast vrasjeje. Sipas priftit, T.J. kishte qenë dëshmitare e vrasjes së djalit të saj**,** z. Radisllav Jovanoviq në fshatin Mushtisht, në qershor të vitit 1999. Ajo ishte sjellë pas ngjarjes në "Kishën ortodokse" në Prizren nga ushtarët e KFOR-it dhe më pas ishte zhvendosur në Serbi. Prifti ishte akoma në kontakt me këtë dëshmitare, e cila mund të qasej lehtë për informata të tjera lidhur me rastin. Ai gjithashtu ia kishte ofruar Policisë së UNMIK-ut një listë të serbëve që akoma ishin të zhdukur nga fshatrat Mushtisht, Dvoran dhe Popovlan. Lista e bashkëngjitur në raport përmban emrat dhe mbiemrat e 22 personave të zhdukur, 16 prej tyre nga Mushtishti, duke përfshirë z. Radisllav Jovanoviq, z. Stanisllav Mitiq, znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq. Në raport thuhet më tej se hetuesi e kishte kontrolluar emrin e z. Radisllav Jovanoviq në bazën e të dhënave të NJHKL-së dhe nuk ishte në gjendje të gjejë ndonjë regjistrim që korrespondonte me atë emër.

67. Dosja gjithashtu përmban një memorandum për përdorim brenda zyrës të NJHKL-së, i datës 6 dhjetor 2001, në të cilin në rubrikën "lënda" thuhet "Dosje e re e mundshme"; në tekstin e memorandumit kërkohet që zyrtarët e NJHKL-së të verifikojnë nëse ata kishin një rast të regjistruar lidhur me vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq. Në rast nuk ishte regjistruar, një vendim se "si të trajtohej ky rast" që kërkohej të merrej.

68. Në një raport inicial, të datës 8 dhjetor 2001 dhe të përfshirë në dosjen hetimore, rasti i z. Radisllav Jovanoviq është regjistruar nga Policia e UNMIK-ut si vrasje. Në raport përmendet një dëshmitare (T.J., e paraqitur këtu si D.J.), deklarata e së cilës akoma nuk ishte marrë.

69. Më 11 dhjetor 2001, një hetues i NJQHP-së i kërkoi Njësitit për Inteligjencë të KFOR-it të ShBA-së që të kontrollojë në bazën e tyre të të dhënave nëse ata kishin informata për rastin e z. Radisllav Jovanoviq. Më 13 dhjetor 2001, hetuesi i njëjtë i kërkoi NJPZH-së të kontrollojë përsëri bazën e tyre të të dhënave për informata lidhur me z. Radisllav Jovanoviq dhe listën e personave tjerë të zhdukur nga fshatrat Mushtisht, Dvoran dhe Popovlan (shih § 66 më lart).

70. Sipas një formulari shtesë/vazhdues, i datës 11 janar 2002, më 10 janar 2002, hetuesi i NJQHP-së vizitoi priftin ortodoks A.N., në Prizren me qëllim të mbledhjes së më shumë informatave nga ai rreth vrasjes së pretenduar të z. Jovanoviq. Në raport pasqyrohen informatat e ofruara nga prifti se T.J. ishte sjellë nga ushtarët e KFOR-it në Kishën Ortodokse në Prizren. Ajo i tha atij se djali i saj ishte vrarë në prani të saj nga "fëmijët" e Mushtishtit, emrat e të cilëve nuk u ofruan. Prifti nuk e dinte nëse trupi i z. Jovanoviq ishte varrosur nga KFOR-i apo ku. Prifti gjithashtu deklaroi se T.J., e cila në atë kohë ishte 93 vjeçe, ishte duke jetuar në Serbi me të afërmit e saj.

71. Sipas një memorandum të NJHKL-së, i datës 30 shtator 2003, më 25 shtator 2003, hetuesit e kontaktuan priftin A.N. (të njëjtin që është përmendur në § 66 më lart) në Prizren dhe morën nga ai informatat se si të kontaktojnë T.J. Po të njëjtën ditë ata e kontaktuan T.J. me telefon dhe pyetën nëse ajo ishte në dispozicion për t'u intervistuar nga Policia e UNMIK-ut në adresën e saj në Serbi. Më 1 tetor 2003, nipi i T.J. e kontaktoi Policinë e UNMIK-ut dhe i informoi ata se intervista mund të bëhej në shtëpinë e tij, ku T.J. ishte duke jetuar, nëse do të sigurohej një autorizim nga Policia serbe.

72. Më 2 tetor 2003, hetuesit kontrolluan listën e personave të zhdukur e cila u ishte dhënë atyre nga prifti A.N., duke e krahasuar me bazën e të dhënave të NJPZH-së. Nga një listë e bashkëngjitur në memo, duket se nga 23 personat në listë, 10 tanimë ishin regjistruar si të zhdukur, duke përfshirë z. Radisllav Jovanoviq, z. Stanisllav Mitiq, znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq.

73. Dosja përfshin deklaratën e priftit A.N., e cila ishte marrë më 10 tetor 2003. Në deklaratën e tij, A.N. tha se ai kishte qenë prift në Mushtisht për pesë vjet para se ai të largohej më 16 qershor 1999, duke pasur frikë për jetën e tij dhe të anëtarëve të familjes së tij. Sipas tij, pas arritjes së trupave të NATO-s, të gjitha shtëpitë serbe në fshat ishin shkatërruar dhe shumë njerëz u zhdukën, siç ai tashmë i kishte raportuar Policisë së UNMIK-ut në dhjetor të vitit 2001. Në fillim të korrikut të vitit 1999, rreth 15 ditë prej largimit nga Mushtishti, ai e kishte takuar T.J. në Shkollën teologjike ortodokse për prift në Prizren, ku ajo ishte sjellë nga KFOR-i. Ajo i tha atij se, ajo e pa djalin e saj duke e vrarë. Ajo qëndroi në Prizren për katër apo pesë muaj dhe pastaj shkoi të jetojë me të afërmit e saj në Serbi. Prifti u tregoi hetuesve rrënojat e shtëpisë së T.J. në Mushtisht, që ata të mund të kenë një pamje të kësaj.

74. Pas një kërkese të NJQHP-së së UNMIK-ut, të datës 30 shtator 2003, Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë vendosi që Policia e UNMIK-ut të marrë një deklaratë nga T.J. në shtëpinë e nipit të saj në Serbi. Në deklaratën e saj, e datës 6 nëntor 2003, T.J., deklaroi se,

pas arritjes së KFOR-it, shumica e fshatarëve të Mushtishtit u larguan nga fshati, por ajo dhe djali i saj Radisllav Jovanoviq qëndruan. Të dielën, më 15 apo 16 qershor 1999, katër pjesëtarë të UÇK-së të armatosur me pushkë dhe thika arritën në shtëpinë e tyre. Pas një bisede dhe diskutimi të shkurtër, njëri nga ta e qëlloi me armë z. Radisllav Jovanoviq. Një fqinje, S.ZH, doli sapo e dëgjoi të shtënën. T.J. i pa katër meshkujt duke e tërhequr zvarrë trupin e djalit të saj në shtëpinë e saj, kërkuan në të me siguri për gjëra me vlerë, pastaj ata e hodhën benzinën nëpër trup dhe ia vunë zjarrin. Ajo e kaloi natën në shtëpinë e fqinjit; kur ajo u kthye në shtëpinë e saj ditën vijuese ajo e gjeti atë të djegur. Ajo ishte në oborrin e saj atë pasdite kur dëgjoi të shtënat nga shtëpia e S.ZH.; pas 30 minutash ajo e pa atë shtëpi gjithashtu duke u djegur. Më vonë, po të njëjtën ditë, dy "shqiptarë" e sollën atë në "ish-stacionin e policisë" i cili ishte "plot luftëtarë shqiptarë të UÇK-së"; ajo ishte mbajtur atje tri ditë e tre net. Ajo deklaroi se një mjek shqiptar nga fshati, të cilin ajo e identifikoi si "djali i R.", e vizitoi atë dhe i solli diçka për të ngrënë dhe pirë dhe barna. T.J. i kërkoi atij të kontrollojë shtëpinë e dhëndrrit të saj për të parë nëse znj. Jovanka Mitiq dhe z. Stanisllav Mitiq ishin akoma të gjallë. Pasi që mjeku nuk u kthye kurrë më, ajo mendoi se ai gjithashtu ishte vrarë. Pasi ajo ishte liruar, ajo u kthye tek ajo që kishte mbetur nga shtëpia e saj dhe e kaloi një javë në një shtëpi të vjetër në oborrin e saj. Më vonë, një fqinje shqiptare, znj. X., i tha se ajo do ta thërrasë KFOR-in pasi ajo nuk mund të garantonte për sigurinë e saj më tutje. Pastaj arritën ushtarët e KFOR-it gjerman dhe e sollën atë në Shkollën teologjike për prift të Prizrenit, ku ajo qëndroi deri në janar të vitit 2000 dhe ku ajo e takoi priftin A.N. Pasi ajo ishte shpërngulur në Serbi, ajo ia ofroi një deklaratë për këto ngjarje Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. T.J. deklaroi se ajo nuk i njihte ndonjë nga luftëtarët e UÇK-së dhe personi i vetëm që ajo e njihte ishte mjeku i lartpërmendur. Ajo e përshkroi personin i cili e vrau djalin e saj, por ajo nuk kishte besim se do të ishte në gjendje ta njohë atë në fotografi. Ajo shtoi, se, me sa e dinte, ajo ishte e mbijetuara e vetme nga 23 serbë të cilët ishin në Mushtisht kur djali i saj u vra; ajo nuk e përmendi me emër ndonjë dëshmitarë tjetër. Ajo nuk e dinte nëse autorët e kishin larguar dhe varrosur më vonë trupin e djalit të saj apo nëse ishte akoma nën rrënojat e shtëpisë, kështu që ajo u kërkoi hetuesve ta vërtetojnë nëse ky ishte rasti. Pasi hetuesit e pyetën atë nëse ajo e njihte F.B. (emri dhe mbiemri i siguruar), emri i të cilit ishte shkruar me ngjyrë në rrënojat e shtëpisë së saj, siç është treguar në fotografi, T.J. u përgjigj se ai ishte nga një lagje afër Mushtishtit. Duke iu referuar një dokumenti të Ministrisë së Punë të Brendshme të Serbisë, hetuesit i kërkuan T.J. ta konfirmojë nëse ishte e vërtetë se djali i saj ishte therur me thikë para se të qëllohej për vdekje, të cilën gjë ajo e hodhi poshtë. E pyetur nga hetuesit rreth fqinjës S.ZH. dhe vajzës së saj, T.J. u përgjigj se, pasi ajo kishte dëgjuar të shtënat që vinin nga shtëpia e saj dhe pastaj e kishte parë shtëpinë duke u djegur, ajo mendon se ata janë vrarë brenda shtëpisë. Ajo gjithashtu i identifikoi rrënojat e shtëpisë së saj në një komplet të fotografive të shtëpisë, të cilat iu ishin treguar hetuesve të UNMIK-ut nga prifti A.N.(shih § 73).

75. Nga një ditar hetimor i Policisë së UNMIK-ut, lidhur me rastin kuptohet se, më 25 nëntor 2003, dhe përsëri më 28 nëntor 2003, hetuesit e UNMIK-ut kontaktuan priftin A.N. dhe i bënë pyetje rreth mjekut shqiptar nga fshati Mushtisht; megjithatë, ai nuk ishte në gjendje të ofrojë emrin e mjekut.

76. Në një raport hetimor të NJQHP-së të datës 25 nëntor 2003, hetuesi përgjegjës për rastin deklaroi se dy dëshmitarët në dispozicion (prifti A.N. dhe T.J.) për rastin ishin intervistuar. Asnjëri nga ta nuk ishte në gjendje "t'i japë me emër apo të identifikojë" ndonjërin nga autorët. Sa i përket mjekut shqiptar të përmendur nga T.J. ("djali i R."), ajo gjithashtu nuk

ishte në gjendje të japë emrin e plotë të tij. Prandaj, hetuesi rekomandoi mbylljen e rastit "derisa të dalin informata të reja" dhe t'i dërgohet NJPZH-së lista e plotë e personave të zhdukur që atyre u ishte dhënë nga prifti, ashtu që ata të mund të regjistrohen. Pas këtij rekomandimi, në një letër të datës 20 janar 2004, PN nga Zyra e Qarkut e Prokurorisë Publike në Prizren i kërkoi NJQHP-së ta mbyllë rastin. Sipas mendimit të prokurorit, duke u bazuar në informatat në dispozicion nuk kishte "dëshmi për të inicuar një hetim gjyqësor" dhe nuk mund të ndërmirrej veprim i mëtejmë për çështjen, po të mos jetë në gjendje një dëshmitar të ofrojë më shumë informata rreth autorëve.

77. Përmes një memorandumi për komunikim brenda zyrës të datës 14 mars 2004, NJQHP-ja ia përcolli NJPZH-së listën e personave të zhdukur nga fshatrat Mushtisht, Dvoran dhe Popovlan për veprim të tyre. Lidhur me rastin e z. Radisllav Jovanoviq, NJQHP-ja deklaroi se rasti po mbahej i mbyllur, ata ishin duke i kërkuar NJPZH-së të verifikojë nëse në shtëpinë e T.J. ishin akoma mbetjet e tij mortore.

78. Pavarësisht nga vendimi i PN për të mos ndjekur rastin më tutje, duket se hetimi ishte rihapur disa muaj më vonë, pas një kërkese të udhëheqësit të DD-së. Në dosjen hetimore është përfshirë një memorandum për komunikim brenda zyrës, i datës 3 gusht 2004, i udhëheqësit të Divizionit Penal të DD-së për udhëheqësin e Njësitit për Krime të Luftës të NJQHP-së dhe shefin e NJQHP-së. Në memorandum, me temën "Pretendimet për krime lufte – viktima: Radovan JOVANOVIQ", thuhet se dosja lidhur me vrasjen e z. Jovanoviq si dhe rrëmbimin nga UÇK-ja të z. Stanisllav Mitiq dhe znj. Jovanka Mitiq, ishte dërguar. Në dokument më tutje thuhet se "duke pasur parasysh pretendimet në këtë rast, hetimi duhet të ndërmerret na Policia e UNMIK-ut dhe jo nga zyrtari lokal i SHPK-së. Prandaj ne kërkojmë që ky rast t'i dorëzohet Njësisë për analizë për shqyrtim fillestar, vlerësim dhe rekomandim për veprim të mëtejmë". E bashkangjitur për memon është një letër, e datës 2 shkurt 2004, nga Qendra Koordinuese për Kosovë dhe Metohi e Qeverisë së Serbisë (QKKM) për "Zyrën e Qarkut të Prokurorisë Publike në Prizren", ku detajohen pretendimet e T.J. në lidhje me vrasjen e z. Jovanoviq, rrëmbimin e z. Stanisllav Mitiq dhe znj. Jovanka Mitiq, si dhe vrasjen e S.ZH. dhe vajzës së saj trevjeçare, dhe kërkohet të merret një intervistë nga T.J. dhe regjistrohet me zë.

79. Dosja përmban kopjen e një e-maili të datës 10 shtator 2004, nga një pjesëtar i stafit të DD-së, me sa duket të adresuar për NJQHP-në. Në e-mail thuhet se në gusht të vitit 2004 "ne i kërkuam Njësitit për KL ta bëjë një shqyrtim fillestar të letrës nga QKKM lidhur me vrasjen e Radisllav Jovanoviq… sipas të dhënave të mia, ekziston një dosje e NJQHP-së # 2001-00114 lidhur me këtë rast. Ky e-mail ka për qëllim të vazhdojë me përcjelljen e rastit nëse ka pasur ndonjë zhvillim të ri. Një intervistë me dëshmitaren e moshuar duket të jetë gjasa e vetme për të shkuar më tej në këtë rast".

80. Rasti i z. Radisllav Jovanoviq është regjistruar gjithashtu nga NJHKL e Policisë së UNMIK-ut me nr. 2004-000096. Dosja hetimore përmban një raport të hetimit ante-mortem, i datës 7 prill 2005, lidhur me rastet e z. Radisllav Jovanoviq (nr. 2004-000096), S.ZH.(nr. 2005-000002), dhe vajzës së S.ZH. (nr. 2005-000003). Në raport thuhet se, më 9 janar 2003, S.J., u raportoi autoriteteve se në qershor të vitit 1999, z. Radisllav Jovanoviq si dhe fqinja e tij S.ZH dhe vajza e saj, ishin rrëmbyer nga shtëpitë e tyre në Mushtisht. nga një grup i pjesëtarëve të armatosur të UÇK-së. Në rubrikën "Hetimi i mëtejmë", në raport thuhet se, më 5 prill 2005, Policia e UNMIK-ut e kishte kontaktuar S.J. përmes telefonit. Ai informoi se raporti i tij bazohet në rrëfimin e T.J. (këtu e përmendur si D.T.), e cila i kishte

parë autorët. Sipas raportit, kjo e fundit ishe 95 vjeçe në atë kohë dhe, për shkak të problemeve me të dëgjuar, ajo nuk mund të intervistohej përmes telefonit. Për këtë arsye, hetuesi rekomandoi që një grup i hetuesve duhet të vizitojë dëshmitaren në Serbi për të marrë rrëfimin më të saktë të ngjarjeve. Në rubrikën "Dëshmitarët e intervistuar" të raportit thuhet "Asnjë nuk është intervistuar". Hetuesi gjithashtu rekomandoi që rasti të mbetet "i hapur në zhvillim e sipër" në kuadër të NJKL-së. Raporti mban nënshkrimin e aprovimit të udhëheqësit të hetimit të NJKL-së.

81. Në një raport të analizës së rastit të NJHKL-së, i datës 24 nëntor 2007, i ndërlidhur me lëndën e NJPZH-së nr. 2001-00114, në rubrikën "Përmbledhje për krimin" thuhet se më 16 qershor 1999, një grup i armatosur shqiptarësh të veshur me rroba me simbole të UÇK-së arritën në shtëpinë ku T.J. ishte duke jetuar në fshatin Mushtisht. Ata filluan debatin me z. Radisllav Jovanoviq, djalin e T.J. dhe e qëlluan atë për vdekje; T.J. ishte dëshmitare e kësaj. Pas kësaj, ata hodhën benzinë mbi trupin e z. Radisllav Jovanoviq, e tërhoqën zvarrë atë në një nga dhomat dhe ia vunë zjarrin shtëpisë. T.J. pastaj ishte sjellë në ish-stacionin e policisë të marrë nga UÇK-ja dhe ishte mbajtur ilegalisht atje për tri ditë. Ajo kurrë më nuk e pa djalin e saj. Në rubrikën "Numri i përgjithshëm i viktimave" thuhet "3"; ndërsa në rubrikën "Numri i deklaratave të viktimave" thuhet "1"; Në rubrikën "Numri i dëshmitarëve të njohur" dhe "Numri i deklaratave të dëshmitarëve" thuhet "2". Në rubrikën "Përshkrim i shkurtër i dëshmisë" thuhet "Nuk ka dëshmi. Të gjitha deklaratat janë regjistruar si duhet". Në fund të raportit, hetuesi deklaron se rekomandohet mbyllja e rastit për shkak të mungesës së dëshmisë. Sipas hetuesit, kishte vetëm një mundësi për t'i identifikuar autorët, që ishte dëshmia e T.J. Megjithatë nëna e viktimës "nuk ishte në gjendje të identifikojë askënd në vargun me fotografi dhe as të na ofrojë ndonjë informatë tjetër relevante lidhur me sulmuesit në deklaratën e saj". Hetuesi theksoi më tutje se dëshmitarja ishte në atë kohë "mirë duke marrë parasysh vitet (95)" dhe jetonte në Serbi. Për këtë arsye, rekomandohej të mbyllej përkohësisht rasti "deri në kohën që do të gjendet dëshmi e re".

82. Dosja përmban më tutje një material të shtypur të NJHKL-së së UNMIK-ut, i marrë më 15 dhjetor 2007, në lidhje me lëndën nr. 2001-00114, në të cilin tregohet se rasti ishte regjistruar më 16 dhjetor 2001 dhe azhurnuar më 14 mars 2004. Në raport thuhet se "pas intervistimit të dëshmitarëve, dhe tregimit të vargut me fotografi, ata ende nuk ishin në gjendje përfundimisht të identifikojnë ndonjë nga autorët". Pas kësaj, në konsultim me PN, u vendos se nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për të filluar një "hetim gjyqësor" dhe se dosja duhet vendosur në "listën joaktive". Në listën e viktimave në raport paraqitet, përveç z. Radisllav Jovanoviq, gjithashtu edhe z. Stanisllav Mitiq dhe znj. Jovanka Mitiq. Në rubrikën "Dëshmitarët", të raportit paraqitet, përveç T.J., gjithashtu A.N. (prifti).

*Për zhdukjen e z. Stanisllav Markoviq*

83. Duket se një rast për një person të zhdukur për z. Stanisllav Markoviq është hapur nga NJPZH e Policisë së UNMIK-ut në vitin 2002, lënda nr. 2002-000166.

84. Në dosjen hetimore është përfshirë një formular i NJPZH-së, pa datë, për identifikim të viktimës për z. Stanisllav Markoviq, lënda nr. 2002-000166, dhe një formular me të dhëna ante-mortem i plotësuar nga KNKK-ja në Beograd, i cili gjithashtu nuk ka asnjë datë. Në formularin me informata ante-mortem thuhet se z. Markoviq ishte zhdukur më 13 qershor 1999, së bashku me tre persona të tjerë, z. Marko Markoviq, Marko Nikoliq dhe Cveta Nikoliq, pasi ata kishin mbetur në shtëpitë e tyre në fshatin Mushtisht. Në shënimet në

raportin e NJPZH-së për vazhdim të rastit tregohet se informatat ante-mortem në lidhje me z. Stanisllav Markoviq ishin futur në bazën e të dhënave të NJPZH-së në periudhën mes 13 marsit dhe 10 dhjetorit të vitit 2002.

85. Dosja hetimore përmban raportin e hetimit ante-mortem të NJKL-së së Policisë së UNMIK-ut për rastin e z. Markoviq, lënda e NJPZH-së nr. 2002-000166, i cili ka datën 31 janar 2005. Në rubrikën "Të dhëna të dëshmitarit" në raport jepen emri, mbiemri dhe qyteti me banim në Serbi i V.M., motrës së personit të zhdukur. Në rubrikat "Hetimi i mëtejmë" dhe "Dëshmitari i intervistuar" të raportit thuhet, "dëshmitarja jeton në Serbi, s'ka numër telefoni" përkatësisht "asnjë". Në "Deklaratën e dëshmitarit", në raport thuhet "Sipas raportit z. Markoviq u zhduk më 13 qershor 1999, së bashku me tre persona të tjerë, d.m.th. z. Marko Markoviq, Marko Nikoliq dhe Cveta Nikoliq dhe personat e zhdukur kishin mbetur në shtëpitë e tyre në fshat". Përfundimi i hetuesit është se "pas hetimeve, është e pamundshme në këtë kohë të gjendet një dëshmitar i paanshëm rreth vendit të ngjarjes. Nuk ka asnjë informatë që çon kah gjetja e mundshme e PZH-së. Ky rast duhet të mbetet në zhvillim e sipër në kuadër të NJKL-së. Raporti mban nënshkrimin për aprovim të udhëheqësit të hetimit të NJHKL-së.

86. E bashkëngjitur në dosjen hetimore është gjithashtu një kopje e një kallëzimi penal, pa datë, i paraqitur kundër autorëve të panjohur nga ankuesi z. Todor Markoviq te PN i Zyrës së Qarkut të Prokurorisë Publike në Prizren. Në kallëzim, thuhet se z. Stanisllav Markoviq ishte rrëmbyer nga pjesëtarët e UÇK-së më 11 qershor 1999 nga shtëpia e tij në Mushtisht dhe se prej asaj kohe vendndodhja e tij është e panjohur. Zhdukja i është raportuar KFOR-it, icili me sa duket kishe regjistrime zyrtare për këtë, KNKK-së dhe të gjitha "institucioneve ndërkombëtare të shteteve në Kosovë". Megjithatë, ankuesi nuk ka marrë asnjë informatë rreth fatit të babait të tij. Nuk ka dëshmi në dosje që tregon se ishte përcjell më tutje ky kallëzim penal.

*Për zhdukjen e z. Bozhidar Jovanoviq*

87. Në mesin e dokumenteve lidhur me zhdukjen e z. Bozhidar Jovanoviq është një formular i KNKK-së, pa datë, i hetimit ante-mortem në të cilin thuhet se ai u zhduk nga Mushtishti më "13 apo 14 qershor 1999", dhe gjithashtu në të tregohet se gruaja dhe djali i viktimës ishin duke jetuar në Qendrën kolektive për persona të zhdukur.

88. I bashkëngjitur në dosjen hetimore është një rend i ditës njëfaqësh i takimit të Grupit të përbashkët punues për identifikim dhe zhvarrim, i datës 11 dhjetor 2001. Emri i z. Bozhidar Jovanoviq gjendet në mesin e pikave të rendit të ditës dhe një shënim me dorë tek emri i tij,ku thuhet "në progres".

89. Dokumenti i fundit në dosjen hetimore është një raport i NJPZH-së për vazhdim të rastit për rastin e z. Bozhidar Jovanoviq, i regjistruar në dosjen nr. 2003-000119. Në një shënim të datës 2 maj 2003 tregohet se, atë ditë, informatat ante-mortem ishin futur në bazën e të dhënave të NJPZH-së.

90. Dosja përmban një memorandum për përdorim brenda zyrës të udhëheqësit të Zyrës së UNMIK-ut në Beograd për udhëheqësin e NJPZH-së, me një letër të motrës së viktimës adresuar PSSP-së. Në letër, të datës 30 korrik 2007, motra e z. Bozhidar Jovanoviq deklaroi, mes tjerash, se ajo nuk kishte ndonjë informatë të re rreth vëllait të saj, i cili kishte

mbetur në Mushtisht. Ajo e kishte informuar Qendrën për të Drejtën Humanitare, KNKK-në dhe Kryqin e Kuq Jugosllav për zhdukjen e tij. Në një raport të NJPZH-së për vazhdim të rastit për z. Bozhidar Jovanoviq thuhet se, pas kontrollit të parë, duket se nuk ka ndonjë gjurmë për të në bazën e të dhënave të NJPZH-së. Në raport tregohet një listë e gjërave për t'u bërë nga NJPZH-në në Beograd (kontrollo "DB (BDh) serbe në Prishtinë" për informata të tjera; kërko informata të tjera në Qendrën për të Drejtën Humanitare; verifiko nëse KNKK ka mbledhur informatat ante-mortem dhe, nëse jo, kërkoju atyre që ta bëjnë këtë; më pas dërgoje krejt dosjen në Prishtinë dhe "mbaje shefin e zyrës të informuar (me shkrim) rreth hapave në këtë dosje") si dhe në Prishtinë (hape një dosje në bazën e të dhënave të NJPZH-së; duke i futur informatat ante-mortem në bazën e të dhënave dhe përcille rregullisht rastin).

91. Dosja gjithashtu përmban kopjen e faqes së dytë të një letërpërgjigjeje të nënshkruar nga drejtori i DD-së së UNMIK-ut, për motrën e viktimës. Për sa i përket zhdukjes së z. Bozhidar Jovanoviq, në letër thuhet: "Unë gjithashtu e kuptoj se ju nuk e keni regjistruar lëndën në Njësitin e UNMIK-ut për persona të zhdukur. Ju ftoj ta bëni këtë duke vizituar zyrën e Njësitit në Graçanicë (Kosovë) çdo të premte prej 10.00 deri më 14.00 (zyra është e vendosur pas Komunës së Graçanicës), personalisht apo në mënyrë alternativepërmes të afërmit të ngushtë apo anëtarit të familjes. Nëse kjo nuk është e mundshme … atëherë ju lutemi kontaktoni Zyrën Ndërlidhëse të UNMIK-ut në Beograd, e cila mund të jetë në gjendje t'ju ndihmojë".

**D. Sqarimi i EULEX-it**

92. Siç është përmendur më lart (§ 5), më 18 dhjetor 2009 Paneli i kërkoi EULEX-it që të sigurojë informata shtesë për dyzet etri ankesat para Panelit. Në përgjigjen e tyre, të datës 23 mars 2010, zyrtarët e EULEX-it sqaruan se ata kishin kërkuar burime në dispozicion, duke përfshirë listën e rasteve "të gjetura në korrik të vitit 2009 në hapësirën e arkivit në ndërtesën e DD-së (që nuk i janë dorëzuar zyrtarisht EULEX-it nga UNMIK-u sepse nuk ishin më tutje "aktive" por të refuzuara, të përfunduara apo të mbyllura)."

93. Në përgjigjen e njëjtë, EULEX-i shtoi se kërkimi nuk ishte shterues, pasi burimet në dispozicion nuk siguruan informata për:
    - Lëndët, raportet penale apo informatat që Policia e UNMIK-ut nuk i barti kurrë te prokurorët e UNMIK-ut, apo ndryshe nuk arritën kurrë te prokurorët e UNMIK-ut;
    - Lëndët, të cilat ishin trajtuar nga Policia e UNMIK-ut dhe pastaj ishin transferuar te policia apo prokurorët lokalë, pa iu raportuar prokurorëve të UNMIK-ut apo EULEX-it;
    - Shumë raste të cilat ishin trajtuar nga prokurorët e UNMIK-ut, para krijimit të një regjistri të centralizuar të lëndëve nga DD i UNMIK-ut në vitin 2003.

94. Megjithatë, kërkimi në dosjet e EULEX-it siguroi informata vetëm për dy raste të vëna në listë në kërkesën e Panelit të 18 dhjetorit 2009. Nuk u gjet asnjë dosje apo informatë për dyzet e një rastet e tjera, duke përfshirë ankesën e znj. Smiljana Gjekiq (lënda nr. 109/09). EULEX-i nuk ishte në gjendje të konfirmojë nëse lëndët për të cilat ishin gjetur dosjet "ishin hetuar ndonjëherë nga Policia dhe/apo prokurorët e UNMIK-ut."

## III. ANKESAT

95. Ankuesit ankohen rreth dështimit të pretenduar të UNMIK-ut që të hetojë si duhet vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq. Në lidhje me këtë, Paneli mendon që ankuesit mbështeten në shkeljen e obligimit procedural të nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

96. Ankuesit, po ashtu, ankohen për dhimbjet dhe vuajtjet mentale të supozuara që u janë shkaktuar atyre nga kjo situatë. Në lidhje me këtë, Paneli mendon që ankuesit bazohen në nenin 3 të KEDNJ-së.

## IV. LIGJI

### A. Shkelja e pretenduar e obligimit procedural sipas nenit 2 të KEDNJ-së

#### 1. Fusha për t'u shqyrtuar nga Paneli

97. Në përcaktimin e asaj nëse konsideron që ka pasur një shkelje të nenit 2 (obligimi procedural) të KEDNJ-së, Paneli është i vetëdijshëm për praktikën ekzistuese gjyqësore, veçanërisht atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, Paneli është gjithashtu i vetëdijshëm që ankesat para tij dallojnë në disa mënyra domethënëse nga ato të paraqitura para asaj gjykate. E para, i padituri nuk është një shtet, por një administratë e përkohshme ndërkombëtare në një territor me mandat që t'i ushtrojë përkohësisht përgjegjësitë në Kosovë. Asnjë përgjegjësi nuk i bie UNMIK-ut sa u përket obligimeve esenciale sipas nenit 2 të KEDNJ-së. E dyta, si në një numër të kufizuar të lëndëve para Gjykatës Evropiane, ata që dyshohen të jenë përgjegjës për vrasjet dhe/apo rrëmbimet e pretenduara, janë në të gjitha rastet para Panelit me palë joshtetërore**,** kryesisht që kanë të bëjnë me konfliktin, por jo vetëm me të. Këta janë faktorët për t'u marrë parasysh nga Paneli, meqë vlerëson obligimet pozitive procedurale të një organizate ndërqeveritare në lidhje me aktet e kryera nga palët e treta, në një territor mbi të cilin e ka kontrollin e përkohshëm legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

98. Para se ta shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës, Paneli duhet ta qartësojë fushën e shqyrtimit.

99. Paneli thekson që me miratimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1, më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin që t'i zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve të veta. Ky zotim u detajua në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të 12 dhjetorit 1999, me të cilën UNMIK-u mori obligimet sipas këtyre instrumenteve për të drejtat e njeriut: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet me të, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP), Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave, Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Tjetër Mizor, Jonjerëzor dhe Degradues dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijëve.

100. Paneli, po ashtu, thekson që neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut numër 2006/12, i 23 marsit 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut siguron që Paneli "shqyrton ankesat nga çdo person apo grup individësh që pohojnë të jenë viktimë e

shkeljes së të drejtave (të tyre) të njeriut nga UNMIK-u". Pra vetëm aktet apo lëshimet që i atribuohen UNMIK-ut bien brenda juridiksionit *rationepersonae* të Panelit. Në lidhje me këtë, duhet përmendur, siç është theksuar më lart, që prej 9 dhjetorit 2008 UNMIK-u nuk ushtron më autoritetin ekzekutiv mbi gjyqësinë e Kosovës dhe aparatin për zbatimin e ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk bart asnjë përgjegjësi për ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut që pretendohet se janë kryer nga ato autoritete. Sa i përket ankuesve që ankohen rreth akteve që kanë ndodhur pas asaj date, ato janë jashtë juridiksionit *rationepersonae* të Panelit.

101. Po ashtu, Paneli thekson që, sa i përket juridiksionit të vet *rationemateriae*, siç vijon nga neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ai mund t'i shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut. Kjo nënkupton që mundet vetëm t'i shqyrtojë aktet apo lëshimet për të cilat është bërë ankesë rreth pajtueshmërisë së tyre me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cekura më lart (shih § 99). Në rastin e veçantë të vrasjeve apo zhdukjeve në rrethana kërcënimi të jetës, nuk është roli i Panelit t'i zëvendësojë autoritetet kompetente për hetimin e rastit. Detyra e tij është e kufizuar në shqyrtimin e efektivitetit të hetimit penal për vrasjet dhe zhdukjet e tilla, në dritën e obligimeve procedurale që rrjedhin nga neni 2 i KEDNJ-së.

102. Paneli thekson më tutje se neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 siguron që Paneli ka juridiksion mbi ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut "që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që rrjedhin nga faktet të cilat kanë ndodhur para kësaj date, ku këto fakte shkaktojnë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Pra, ngjarjet që kanë ndodhur para 23 prillit 2005, përgjithësisht janë jashtë juridiksionit *rationetemporis* të Panelit. Megjithatë, në rastin kur ngjarjet e tilla kanë shkaktuar një situatë të vazhdueshme, Paneli ka juridiksion t'i shqyrtojë ankesat që ndërlidhen me atë situatë (shih Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), Dhoma e Lartë [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 16064/90 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 18 shtator 2009, §§ 147-149; GJEDNJ, *Qiproja kundër Turqisë* [DHL], numër 25781/94, vendimi i gjykatës, 10 maj 2011, § 136, KEDNJ 2001-IV).

## 2. Parashtresat e palëve

103. Ankuesit në esencë pretendojnë për shkelje lidhur me mungesën e një hetimi adekuat penal për vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe Bozhidar Jovanoviq. Ankuesit gjithashtu deklarojnë që ata nuk ishin informuar nëse ishte duke u zhvilluar një hetim dhe çfarë ishte rezultati.

104. PSSP-ja thekson në parashtresën e tij, të datës 10 dhjetor 2013, se në këtë rast UNMIK-u ishte në gjendje t'i marrë kopjet e dosjeve relevante që më herët ishin mbajtur nga ZPZHML dhe Njësiti për Hetimin e Krimeve të Luftës i Policisë së UNMIK-ut. Megjithatë, PSSP-ja deklaron se UNMIK-u rezervon të drejtën e tij që të japë komente shtesë për çështjen "në çdo fazë të ardhshme, nëse do t'i ofrohen në dispozicion dosje shtesë në lidhje me çështjen".

105. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës sipas nenit 2, PSSP-ja nuk bën dallim në mes rastit të z. Radisllav Jovanoviq dhe atyre të znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq, z. Radisllav Jovanoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq, dhe deklaron se ata të gjithë u zhdukën në rrethana kërcënimi me jetë, rreth ditëve të njëjta kur është

miratuar Rezoluta nr. 1244 (1999) e KS të OKB-së (1999) për themelimin e UNMIK-ut. Ai thekson se në atë kohë situata e sigurisë në Kosovë ishte e tensionuar: "KFOR-i ishte akoma në proces të arritjes së forcës së mjaftueshme për të mbajtur sigurinë publike dhe rendin dhe ligjin dhe kishte një numër të incidenteve serioze penale që kishin si shënjestër serbët e Kosovës, duke përfshirë rrëmbimet dhe vrasjet".

106. PSSP-ja pranon përgjegjësinë e UNMIK-ut për të kryer hetim për rastet e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq, z. Radisllav Jovanoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq sipas nenit 2 të KEDNJ-së, pjesa procedurale, duke filluar prej 11 qershorittë vitit1999. Sipas fjalëve të PSSP-së, "qëllimi esencial i hetimit të tillë është të garantojë implementim efektiv të ligjeve vendore që e mbrojnë të drejtën në jetë, siç përcaktohet me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, të datës 25 korrik 1999, dhe më pas, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, të 12 dhjetorit të vitit 1999, të ndryshuar".

107. PSSP-ja thekson se ankuesit nuk pretendojnë shkelje të obligimit esencial të nenit 2, më saktë pjesës së tij procedurale. PSSP-ja thekson se "obligimi procedural sipas nenit 2 është i dyfishtë: (i) obligim për të përcaktuar përmes hetimit fatin dhe/apo vendndodhjen e personit të zhdukur; dhe (ii) obligim për të kryer hetim që është në gjendje të përcaktojë nëse vdekja ishte shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe që çon kah identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës për zhdukjen dhe/apo vdekjen e viktimës."

108. PSSP-ja më tutje thekson që kur vendoset për kërkesat sipas nenit 2, pjesa procedurale, duhet pasur parasysh që të mos ngarkohet barrë e papërballueshme apo joproporcionale mbi UNMIK-un. Në lidhje me këtë, PSSP-ja rikujton gjykimin e 15 shkurtit 2011, të dhënë nga Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut në rastin *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, duke theksuar paragrafin 70:

> "Gjykata merr parasysh situatën komplekse në Bosnjë e Hercegovinë, veçanërisht dhjetë vjetët e para pas luftës. Në situatë të tillë pas konflikti, ajo që arrin në barrë të papërballueshme dhe/apo joproporcionale duhet të matet nga faktet dhe konteksti shumë i veçantë. Në lidhje me këtë, gjykata thekson që më shumë se 100,000 njerëz u vranë, pothuajse 30,000 njerëz u zhdukën dhe më shumë se dy milionë njerëz u zhvendosën gjatë luftës në Bosnjë e Hercegovinë. Duhej bërë zgjedhje të paevitueshme sa i përket prioriteteve dhe burimeve të pasluftës. Veç kësaj, pas një lufte të gjatë dhe brutale, Bosnja dhe Hercegovina bëri një rishikim fundamental të strukturës së saj të brendshme dhe sistemit politik: u formuan entitetet dhe kantonet në pajtim me Marrëveshjen e Paqes së Dejtonit, u paraqitën marrëveshjet për ndarjen e pushtetit me qëllim të sigurimit të barazisë efektive ndërmjet "popujve konstituivë" në shoqërinë e pas konfliktit (shih *Sejdiq dhe Finci kundër Bosnjë e Hercegovinës* [DHL], nr. 27996/06 dhe 34836/06, KEDNJ 2009-...), duhej krijuar institucione të reja dhe ato ekzistueset duhej ristrukturuar. Pak ngurrim nga ana e ish-palëve ndërluftuese për të punuar me ato institucione të reja mund të pritej në periudhën e pas luftës, siç dëshmohet në rastin aktual. Ndërsa është e vështirë të përcaktohet me saktësi se kur ky proces saktësisht përfundoi, Gjykata konsideron se sistemi ligjor vendor është dashur të arrijë që të bëhej i aftë të merret me zhdukjet dhe shkeljet tjera serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare deri në vitin 2005, pas verifikimit gjithëpërfshirës të

emërimit në polici dhe gjyqësi dhe themelimit të sektorëve për krime lufte në Bosnjë e Hercegovinë.

Duke marrë parasysh krejt këtë dhe meqë nuk ka pasur periudhë substanciale të mosaktivitetit pas vitit 2005 nga ana e autoriteteve vendore në rastin aktual, Gjykata konkludon se, në rrethanat e marrjes së kohës materiale, hetimi penal vendor mund të konsiderohet se është kryer me shpejtësi dhe ekspeditivitet të arsyeshëm".

109. Sipas mendimit të PSSP-së, UNMIK-u hasi në një situatë shumë të ngjashme në Kosovë "prej vitit 1999 deri më 2008" si ajo në Bosnjë "prej vitit 1995 deri më 2005". PSSP-ja thekson se mijëra njerëz u zhvendosën apo u zhdukën gjatë konfliktit. Shumë nga personat e zhdukur u rrëmbyen, u vranë dhe u varrosën në varre të pashënuara brenda apo jashtë Kosovës, gjë që e bëri shumë të vështirë të gjendet vendndodhja dhe marrjen e mbetjeve të tyre mortore.

110. Në qershor të vitit 2002, UNMIK themeloi ZPZHML-në me mandat që të përcaktojë fatin e të të zhdukurve; megjithatë puna e saj hasi në shumë sfida në fillim të operacioneve, për shkak të punës më parë të bërë kryesisht nga palët, të pavarura nga UNMIK-u. Në veçanti, PSSP-ja thekson që mbledhja e dëshmive për krime të luftës filloi me arritjen e NATO-s në vitin 1999 me ekipe të pavarura nga disa shtete që vepronin nën bashkërendimin e lirë të TNPJ-së. Mungesa e procedurave standarde të operimit apo centralizimit çoi te problemet me dëshmitë e mbledhura në këtë fazë. Në vitin 2000, TNPJ-ja ndërmori një operacion të madh të centralizuar të mjekësisë ligjore, me bazë në morgun e Rahovecit, me procedura standarde operuese për të gjitha ekipet e mjekësisë ligjore përveç atij britanik, i cili operoi në mënyrë të pavarur jashtë Prishtinës. PSSP-ja deklaron që, në përpjekje për të demonstruar se krimet ishin sistematike dhe gjithëpërfshirëse, ekipet e TNPJ-së kryen autopsitë në sa më shumë trupa që ishte e mundshme, duke kryer pak apo aspak punë identifikuese; për më tepër, trupat e paidentifikuar të zhvarrosura në vitin 1999, u rivarrosën në vende ende të panjohura për ZPZHML-në. Pasi TNPJ-ja përfundoi punën e vet në vitin 2000, NJPZH-ja e Policisë së UNMIK-ut vazhdoi hetimet në shkallë të vogël për personat e zhdukur "*ex-officio*, pa ndonjë strategji më të gjerë ndjekëse". Si pasojë, u mblodh një sasi e madhe e informatave të pastrukturuara.

111. PSSP-ja thekson që gjetja dhe identifikimi i të zhdukurve në këtë kontekst siç është përshkruar më lart ishte shumë e vështirë dhe detyrë që merrte kohë. Ai thekson më tutje se numri i personave të kthyer dhe identifikuar nga ZPZHML-ja është "dëshmi e vrullit të punës së saj ndërmjet viteve 2002-2008" dhe se "vazhdohej me gjetjen e më shumë trupave në vendet e varrimit dhe me bërjen e më shumë identifikimeve dhe kthimeve të trupave tek anëtarët e familjes duke u bazuar shpesh në informatat që përmbanin dosjet e ZPZHML-së së UNMIK-ut". PSSP-ja thotë në vazhdim se "prandaj, është e qartë që procesi i krijimit të një sistemi të aftë të merret në mënyrë efektive me zhdukjet dhe shkeljet e tjera serioze të së drejtës ndërkombëtare humanitare ka qenë në rritje" në Kosovë siç paraqitet në rastin *Paliq*, të përmendur më lart. PSSP-ja thekson më tutje se ky proces varej nga një numër i palëve dhe jo vetëm nga UNMIK-u, sikur Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe organizatat lokale për personat e zhdukur."

112. PSSP-ja më tutje argumenton që rrënjësore për të kryer hetime efektive është një forcë policore profesionale, e trajnuar mirë dhe e pajisur mirë dhe se një forcë e tillë nuk ka ekzistuar në Kosovë pas konfliktit. Në vakuumin për kryerjen e detyrave policore pas përfundimit të konfliktit, UNMIK-u duhej të ndërtonte një Shërbim të ri Policor të Kosovës nga zeroja, një detyrë e gjatë dhe sfiduese e cila, sipas PSSP-së, akoma është në progres. PSSP-ja po ashtu deklaron që Policia e UNMIK-ut hasi në sfida të shumta në ushtrimin e funksioneve për zbatimin e ligjit që gradualisht iu bartën nga KFOR-i në vitin 1999-2000. Në lidhje me këtë, ai përmend Raportin vjetor të Policisë së UNMIK-ut të vitit 2000, që përshkruan situatën si në vijim:

> "Policia e UNMIK-ut duhej të merrej me pasojat e luftës, trupat e vdekur dhe shtëpitë e plaçkitura dhe të djegura. Dhuna etnike shpërtheu përmes dëbimeve ilegale, marrjes me forcë të pronave, djegies së shtëpive dhe dhunës fizike kundër komuniteteve në gjithë Kosovën. Temperamentet dhe tensionet ishin të larta ndërmjet të gjitha grupeve etnike, të rënduara nga raportet për personat e humbur dhe të vdekur. U bë imperativ për Policinë e UNMIK-ut që të krijojë rendin dhe të ndërtojë shpejt një strukturë për të regjistruar dhe hetuar krimet.
>
> E gjithë kjo duhej të bëhej me burime të kufizuara fizike dhe njerëzore. Duke qenë misioni i parë ekzekutiv në historinë e OKB-së, koncepti, planifikimi dhe zbatimi zhvilloheshin në terren. Me 20 nacionalitete të ndryshme kontribuuese në fillim, ishte një detyrë shumë sfiduese për drejtuesit e policisë të krijojnë praktika të përgjithshme për rezultate optimale në një ambient me rrezik të lartë."

113. PSSP-ja thekson se NJHKL e Policisë së UNMIK-ut përfshinte të dyja Policinë e UNMIK-ut dhe policët lokalë të Shërbimit Policor të Kosovës dhe u fokusua në hetimin penal të rasteve të personave të zhdukur. Përgjegjësia e tyre përfshinte gjetjen e varrezave ilegale, identifikimin e autorëve dhe mbledhjen e dëshmive në lidhje me krimin. Policët ndërkombëtarë të UNMIK-ut që punonin në rastet e personave të zhdukur duhej t'i përshtateshin kryerjes së hetimeve në një territor dhe vend të huaj, me mbështetje të kufizuar nga Policia e Kosovës ende në zhvillim.

114. Ai deklaron më tutje se, pas konfliktit të gjitha institucionet lokale në Kosovë, duke përfshirë institucionet për zbatimin e ligjit dhe ato përgjegjëse për gjetjen e të zhdukurve ishin jofunksionale dhe duhej formuar nga e para. Përveç kësaj, hetuesit shpesh haseshin me situata, ku individët që kishin dije relevante për vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur, nuk deshën të zbulonin këtë informatë. Sipas PSSP-së, të gjitha këto kufizime penguan në aftësinë e Policisë së UNMIK-ut për t'i kryer hetimet sipas standardeve që mund të priten nga shtetet me institucione më të zhvilluara të cilat nuk ndeshen me numër të madh rastesh të kësaj natyre të lidhura me situatën pas konfliktit.

115. Për sa i përket rastit të z. Radisllav Jovanoviq, PSSP-ja deklaron se një dosje e policisë mbi vrasjen e pretenduar ishte hapur në dhjetor të vitit 2001. Në këtë kohë, Policia e UNMIK-ut e vizitoi për herë të parë priftin dhe dëshmitarin A.N. dhe u dërgoi njoftime Njësitit të Inteligjencës të ShBA-së në KFOR, NJPZH së UNMIK-utdhe KFOR-it gjerman, për t'iu kërkuar të kontrollojnë bazat e të dhënave në lidhje me z. Radisllav Jovanoviq. Policia përsëri e vizitoi A.N. në janar të vitit 2002.

116. Në shtator të vitit 2003, pas shqyrtimit të dosjes nga DD, rasti iu ricaktua një hetuesi të NJKL-së NJQHP-së. PSSP-ja deklaron se, në këtë moment, nuk mund të gjendej asnjë informatë për rastin e z. Radisllav Jovanoviq në bazën e të dhënave të NJQHP-së. Në tetor të vitit 2003, hetuesi i NJKL-së së NJQHP-së kontaktoi përsëri A.N., mori nga ai një deklaratë dëshmitari dhe detajet e kontaktit për dëshmitaren tjetër, T.J., dhe u soll nga ai në vend të ngjarjes me qëllim të marrjes së fotografive të pronës së viktimës dhe krijimit të një vargu fotografish. Në nëntor të vitit 2003, një deklaratë dëshmitari nga T.J., ishte marrë nga hetuesi në Beograd, Serbi. Sipas PSSP-së, megjithatë, T.J. "nuk i ofroi Policisë së UNMIK-ut informata të dobishme për qëllime hetimore". Në veçanti, ajo bëri vetëm "një përshkrim shumë të përgjithshëm fizik të njeriut që e vrau djalin e saj" dhe "ajo nuk ishte e sigurt se mund ta njihte atë në fotografi". Ajo nuk ishte në gjendje të ofrojë ndonjë emër tjetër të dëshmitarëve të mundshëm apo të dyshuarve në fshat, përveç emrit të mjekut nga fshati, i cili i ndihmoi asaj derisa ishte në mbajtje. Ajo nuk ishte në gjendje të tregojë nëse mbetjet mortore të djalit të saj kishin mbetur në rrënoja të shtëpisë apo ishin larguar nga autorët dhe gjithashtu ajo nuk ishte në gjendje të thotë nëse fshatari me inicialet "F.B", emri dhe mbiemri i të cilit ishte shkruar në rrënojat e pronës së saj, mund të ndërlidhej me vrasjen e djalit të saj. Për këtë arsye, në janar të vitit 2004, PN i UNMIK-ut në Prizren, të cilit i ishte dërguar dosja, konsideroi se nuk kishte dëshmi të mjaftueshme për të filluar hetim gjyqësor për çështjen. Në mars të vitit 2004, NJKL e NJQHP-së i kërkoi NJPZH-së ta regjistrojë z. Radisllav Jovanoviq si të zhdukur.

117. PSSP-ja gjithashtudeklaron se më vonë, në gusht të vitit 2004, udhëheqësi i Divizionit Penal të DD-së, pas një raporti nga Qeveria e Serbisë, kërkoi hetim që do të kryhej nga Policia e UNMIK-ut "dhe jo nga policët lokalë të Kosovës" dhe që rasti t'i dorëzohej Njësisë për analizë për shqyrtim fillestar, vlerësim dhe rekomandim për veprim të mëtejmë.

118. Rasti ishte shqyrtuar më tutje nga Policia e UNMIK-ut në vitin 2007, kur një hetues ndërkombëtar i NJKL-së theksoi se nuk ka asnjë dëshmi se të gjitha deklaratat ishin regjistruar dhe rekomandoi mbylljen e rastit. PSSP-ja përmend raportin për rastin të Policisë së UNMIK-ut duke deklaruar se "pasi ishin intervistuar dëshmitarët, dhe ishte treguar vargu me fotografi, ata ende nuk ishin në gjendje përfundimisht të identifikojnë ndonjërin nga autorët".

119. Sa i përket zhdukjes së z. dhe znj. Mitiq, PSSP-ja deklaron se kërkesat për kërkim për secilin nga ta ishin paraqitur nga KNKK në nëntor të vitit 1999 dhe se dosjet për persona të zhdukur ishin hapur nga NJPZH e UNMIK-ut në mars-prill të vitit 2002. Hetuesit provuan që t'i kontaktojnë anëtarët e familjes përmes telefonit por pa sukses. Rasti ishte rishqyrtuar në shtator të vitit 2008; megjithatë për shkak të mungesës së informatave mbi vendndodhjen e personave të zhdukur, ai mbahej në zhvillim e sipër "deri tek informatat e tjera".

120. Lidhur me zhdukjen e z. Bozhidar Jovanoviq, PSSP-ja deklaron se një kërkesë për kërkim e KNKK-së ishte hapur në shkurt të vitit 2001 dhe se një dosje për person të zhdukur e NJPZH-së ishte hapur "vetëm më 2 maj 2003".

121. Lidhur me zhdukjen e z. Stanisllav Markoviq, një kërkesë për kërkim ishte bërë nga KNKK në qershor të vitit 2000 dhe një dosje për person të zhdukur e NJPZH-së ishte

hapur në mars të vitit 2002. Në janar të vitit 2005, pasi nuk kishte informata mbi vendndodhjen e personit të zhdukur, rasti mbeti i hapur dhe joaktiv.

122. Në dritë të kësaj që u tha më lart, PSSP-ja thekson se sipas dosjeve të ofruara hetimore, "UNMIK-u veproi në pajtim me obligimin e tij për të hapur dhe zhvilluar me shpejtësi hetim policor kurdo që kishte në dispozicion informata relevante. Policia e UNMIK-ut intervistoi dy dëshmitarët e vetëm, megjithëse ata nuk ishin në gjendje të ofrojnë informata vendimtare për të përcaktuar fatin dhe vendndodhjen e z. Stanisllav Mitiq, znj. Jovanka Mitiq dhe z. Radisllav Jovanoviq dhe identifikuar autorët". Sa i përket z. Bozhidar Jovanoviq dhe z. Stanisllav Markoviq, dosja hetimore, sipas PSSP-së "zbulon një mungesë të përgjithshme të informatave". Të gjitha hetimet ishin zhvilluar deri më 2007-2008 duke ndjekur "të gjitha pistat relevante hetimorekur kjo ishte e mundshme".

123. PSSP-ja gjithashtu rikujton argumentin e paraqitur në rastet e tjera të personave të zhdukur se "pa paraqitjen e dëshmitarëve apo gjetjen e dëshmive fizike, hetimet policore pashmangshëm ngecin për shkak të mungesës së dëshmisë". PSSP-ja deklaron se "në periudhën nën shqyrtim të PKDNJ-së, nuk u paraqit asnjë dëshmitar tjetër i zhdukjes së pretenduar dhe nuk u gjet asnjë dëshmi fizike nga hetuesit".

124. Prandaj, PSSP-ja argumenton se Policia e UNMIK-ut veproi në pajtim me kërkesat procedurale të nenit 2 të KEDNJ-së.

125. PSSP-ja gjithashtu informoi Panelin se "pasi ka mundësi të ekzistojnë informata shtesë dhe bindëse, përveç dokumenteve të përmendura më lart, UNMIK-u ruan të drejtën që të bëjë komente shtesë për këtë çështje". Megjithatë, nuk është bërë asnjë komunikim tjetër deri më tani në këtë drejtim, përveç konfirmimit të hapjes së plotë të dosjeve hetimore.

## 3. Vlerësimi i Panelit

126. Paneli konsideron që ankuesit thirren në shkeljen e obligimit procedural që rrjedh nga e drejta për jetë, e garantuar me nenin 2 të KEDNJ-së, në atë që Policia e UNMIK-ut nuk kreu një hetim efektiv për vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq.

### *a) Dorëzimi i dosjeve relevante*

127. PSSP-ja e venë re se të gjitha dosjet në dispozicion në lidhje me hetimin i janë paraqitur Panelit. Megjithatë, në komentet e tij të 10 dhjetorit të vitit 2013, PSSP-ja gjykon se dosjet hetimore mund të jenë jo të plota (shih § 104 më lart). Megjithatë, më 21 shkurt 2014, UNMIK-u i konfirmoi Panelit se hapja e dosjeve mund të konsiderohet e plotë (shih §24 më lart).

128. Siç është përmendur më lart (§§ 5 dhe 7), Paneli gjithashtu i kishte kërkuar EULEX-it të ofrojë informata shtesë në lidhje me rastin, por EULEX-i nuk ishte në gjendje ta bëjë këtë (shih §§ 92-94 më lart).

129. Paneli thekson se në nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, thuhet që Paneli mund të kërkojë dorëzimin nga UNMIK-u të çdo dokumenti dhe që PSSP-ja të bashkëpunojë me Panelin dhe të sigurojë ndihmën e nevojshme duke përfshirë, në veçanti,

lëshimin e dokumenteve dhe informatave relevante për ankesën. Paneli në lidhje me këtë i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që duhet nxjerrë konkluzion nga sjellja e palës së paditur gjatë procedurave, duke përfshirë dështimin e vet "për t'i dorëzuar informatat në duart e tyre pa një sqarim të kënaqshëm" (shih GJEDNJ, *Çelikbilek kundër Turqisë,* nr. 27693/95, vendimi i gjykatës, 31 maj 2005, § 56).

130. Paneli gjithashtu thekson që ruajtja e duhur e dosjeve hetimore lidhur me krimet siç janë vrasjet dhe zhdukjet, nga hapja e hetimit deri te dorëzimi i tyre, është vendimtare për vazhdimin e hetimeve të tilla dhe dështimi për ta bërë këtë mund t'i ngritë çështjet *vetvetiu* sipas nenit 2. Paneli poashtu thekson se UNMIK-u nuk ka dhënë ndonjë sqarim rreth asaj se pse dokumentacioni mund të jetë jo i plotë dhe as cilat pjesë mungojnë.

131. Paneli nuk është në pozitë të verifikojë plotësinë e dosjeve të pranuara të hetimit. Prandaj, Paneli do të vlerësojë bazueshmërinë e ankesës në bazë të dokumenteve që janë në dispozicion (në këtë kuptim shih GJEDNJ, *Tsechoyev kundër Rusisë*, nr. 39358/05, vendimi i gjykatës, 15 mars 2011, § 146).

*b) Parimet e përgjithshme në lidhje me obligimin për të kryer hetim efektiv sipas nenit 2*

132. Paneli thekson që obligimi pozitiv për t'i hetuar zhdukjet pranohet gjerësisht në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, së paku që nga rasti i Gjykatës Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut *Velásquez-Rodríguez* (shih Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut (GJNADNJ), *Velásquez-Rodríguez kundër Hondurasit*, vendimi i gjykatës, 29 korrik 1988, seria C nr. 4). Obligimi pozitiv gjithashtu është kërkuar nga KDNJ siç rrjedh nga neni 6 (e drejta në jetë), neni 7 (ndalimi i trajtimit mizor dhe jonjerëzor) dhe neni 9 (e drejta në liri dhe siguri të personit), shpallur në lidhje me nenet 2 (3) (e drejta për kompensim efektiv) e KNDCP (shih KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 6, 30 prill 1982, § 4; KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 31, 26 maj 2004, §§ 8 dhe 18, KDCP/C/21/Rev.1/Shtojca 13; shih gjithashtu mes tjerash, KDNJ, *Mohamed El Awani kundër Xhamahirisë Arabe të Libisë*, komunikata nr. 1295/2004, mendimet e 11 korrikut 2007, KDCP/C/90/D/1295/2004). Obligimi për të hetuar zhdukjet dhe vrasjet gjithashtu kërkohet në Deklaratën e OKB-së mbi Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet e Imponuara (A/Rez/47/133, 18 dhjetor 1992), dhe më tutje e detajuar në udhëzimet e OKB-së, siç janë Manuali i OKB-së mbi Parandalimin Efektiv dhe Hetimin e Ekzekutimeve Jashtëligjore Arbitrare dhe Përmbledhëse (1991) dhe "Udhëzime për Kryerjen e Hetimeve të Kombeve të Bashkuara për Akuzat për Masakra" (1995). Rëndësia e obligimit konfirmohet me miratimin e Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukjet e Imponuara në vitin 2006, e cila hyri në fuqi më 23 dhjetor 2010.

133. Me qëllim të trajtimit të akuzave të ankuesve, Paneli i referohet, në veçanti, praktikës gjyqësore të vërtetuar mirë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbi obligimet procedurale sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Gjykata ka gjetur që "[o]bligimi për të mbrojtur të drejtën në jetë sipas nenit 2 të Konventës, shpallur në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit sipas nenit 1 të Konventës për t'i "siguruar secilit brenda juridiksionit [të vet] të drejtat dhe liritë e përcaktuara në [K]onventë", kërkon shprehimisht që duhet të ketë disa forma të hetimit zyrtar efektiv kur individët janë vrarë …" (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i gjykatës, 27 shtator 1995, § 161, seria A nr. 324; dhe GJEDNJ, *Kaya kundër Turqisë*, vendimi i

gjykatës, 19 shkurt 1998, § 105, *Raportet e gjykimeve dhe vendimeve* 1998-I; shih gjithashtu GJEDNJ, *Jasinskis kundër Letonisë*, nr. 45744/08, vendimi i gjykatës, 21 dhjetor 2010, § 71). Detyra për të kryer një hetim të tillë del në të gjitha rastet e vrasjes dhe vdekjeve tjera të dyshimta, pavarësisht nëse autorët ishin personat privatë apo agjentët e shtetit apo janë të panjohur (shih GJEDNJ, *Kolevi kundër Bullgarisë*, nr. 1108/02, vendimi i gjykatës, 5 nëntor 2009, § 191).

134. Gjykata Evropiane po ashtu ka shpallur që obligimi procedural për të siguruar disa forma të hetimit zyrtar efektiv ekziston, gjithashtu, kur një individ është zhdukur në rrethana kërcënimi me jetë dhe nuk kufizohet në rastet ku është e qartë që zhdukja u shkaktua nga një agjent i shtetit (shih GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 102 më lart në § 136).

135. Autoritetet duhet të veprojnë vetë, sapo çështja të ketë arritur në vëmendjen e tyre, dhe ato nuk mund t'ia lënë atë iniciativës të të afërmit për të paraqitur ankesë formale apo të marrë përgjegjësinë për kryerjen e ndonjë procedure hetimore (shih GJEDNJ, *AhmetÖzkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, nr. 21689/93, vendimi i gjykatës, 6 prill 2004, § 310, shih gjithashtu GJEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, nr. 57950/00, vendimi i gjykatës i 24 shkurtit 2005, § 210).

136. Duke vendosur standardet për një hetim efektiv, gjykata ka shpallur që "përveç të qenit i pavarur, i qasshëm për familjen e viktimës me gatishmërinë dhe saktësinë, dhënies së elementit të mjaftueshëm për shqyrtim publik të hetimit dhe rezultateve të tij, hetimi duhet gjithashtu të jetë efektiv në kuptimin që të jetë në gjendje të shpie në përcaktimin nëse vdekja është shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe nëse po, kah identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës (shih GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 102 më lart, në § 191; shih gjithashtu GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, nr. 4704/04, vendimi i gjykatës, 15 shkurt 2011, § 63). Ky nuk është vetëm një obligim për arritjen e rezultateve, por edhe për përdorimin mjeteve të duhura. Autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapash të arsyeshëm për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin, duke përfshirë ndër të tjera dëshmitë e dëshmitarit okular, dëshmitë e mjekësisë ligjore dhe, ku është e nevojshme, një autopsi e cila siguron të dhëna të plota dhe të sakta për lëndimin dhe një analizë objektive të të gjeturave klinike, duke përfshirë shkaktarin e vdekjes. Çdo e metë në hetim e cila rrezikon aftësinë për të vërtetuar shkaktarin e vdekjes ose personin apo personat përgjegjës, do të rrezikojë të jetë si parregullsi sa i përket këtij standardi (shih GJEDNJ, *AhmetÖzkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 135 më lart, në § 312; dhe *Isayeva kundër Rusisë*, përmendur në § 135 më lart, në § 212).

137. Në veçanti, përfundimi i hetimit duhet të bazohet në analizë të plotë, objektive dhe të paanshme të të gjitha elementeve relevante. Mosndjekja e një piste të qartë të hetimit rrezikon deri në shkallë vendimtare aftësinë për t'i vërtetuar rrethanat e rastit dhe identitetin e atyre që janë përgjegjës (shih GJEDNJ, *Kolevi kundër Bullgarisë*, përmendur në § 133 më lart, në § 201). Megjithatë, natyra dhe shkalla e shqyrtimit, të cilat plotësojnë pragun minimal të efektivitetit të hetimit, varen nga rrethanat e rastit të veçantë. Ato duhen vlerësuar në bazë të të gjitha fakteve relevante dhe në lidhje me realitetet praktike të punës hetimore (shih GJEDNJ, *Velcea dhe Mazăre kundër Rumanisë,* nr. 64301/01, vendimi i gjykatës, 1 dhjetor 2009, § 105).

138. Në mënyrë specifike për sa u përket personave të zhdukur që më vonë janë gjetur të vdekur, e cila situatë nuk është në rastin aktual, gjykata ka shpallur që procedurat e zhvarrimit dhe identifikimit të mbetjeve mortore nuk shterojnë obligimin sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Gjykata konsideron që "obligimi procedural që del nga zhdukja do të mbetet përgjithësisht për sa kohë që vendndodhja dhe fati i personit janë të panjohura dhe kështu është i një natyre të vazhdueshme" (GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur në § 136 më lart në § 46; në kuptimin e njëjtë GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 102 më lart në § 148, *Aslakhanova dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 2944/06 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 18 dhjetor 2012, § 122). Megjithatë, gjykata gjithashtu thekson që ky obligim procedural "nuk përfundon madje edhe me zbulimin e trupit .... Kjo vetëm hedh dritë në një aspekt të fatit të personit të zhdukur dhe obligimi për të shpjeguar zhdukjen dhe vdekjen, dhe gjithashtu për të identifikuar dhe ndjekur çdo autor të akteve të paligjshme në lidhje me këtë përgjithësisht mbetet" (GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur më lart, në § 46; në kuptimin e njëjtë GJEDNJ [DHL], *Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 102 më lart në § 145). Megjithëse gjetja dhe identifikimi pasues i mbetjeve mortore të viktimës munden vetvetiu të jenë arritje të rëndësishme, obligimi procedural sipas nenit 2 vazhdon të ekzistojë (shih GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur më lart, në § 64).

139. Sa i përket kërkesës për shqyrtim publik, gjykata ka shpallur më tutje që duhet të ketë elemente të mjaftueshme të shqyrtimit publik të hetimit apo rezultateve të tij për të siguruar përgjegjësi në praktikë dhe në teori. Shkalla e shqyrtimit të kërkuar publik mundet të ndryshojë mjaft nga rasti në rast. Në të gjitha rastet, megjithatë, i afërmi i viktimës duhet të jetë i përfshirë në procedurë deri në shkallën që mbron interesat e tij legjitime (shih GJEDNJ, *AhmetÖzkan dhe të tjerët*, përmendur në § 135 më lart, në §§ 311-314; GJEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, përmendur në § 135 më lart, në §§ 211-214 dhe rastet e përmendura aty; GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i gjykatës nr. 55721/07, 7 korrik 2011, § 167, KEDNJ 2011).

140. Gjykata gjithashtu ka theksuar rëndësinë e madhe të hetimit efektiv për gjetjen e së vërtetës se çfarë ka ndodhur, jo vetëm për familjet e viktimave por gjithashtu edhe për viktimat e tjera të krimeve të ngjashme, dhe gjithashtu publikun e gjerë, të cilët kanë të drejtë të dinë se çfarë ka ndodhur (GJEDNJ [DHL], *El-Masri kundërish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 39630/09, vendimi i gjykatës, 13 dhjetor 2012, § 191). Organizata e Kombeve të Bashkuara gjithashtu pranon rëndësinë e së drejtës për të ditur të vërtetën. Sipas Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, "e drejta për ta ditur të vërtetën nënkupton njohurinë e tërë dhe të plotë rreth shkeljeve dhe ngjarjeve që kanë ndodhur, rrethanat e tyre specifike dhe kush mori pjesë në to. Në rastin e personave të zhdukur … ajo gjithashtu nënkupton të drejtën për të ditur për fatin dhe vendndodhjen e viktimës" (shih Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Personat e zhdukur, Dokument i OKB-së A/67/267, 8 gusht 2012, § 5; shih gjithashtu Këshilli për të Drejtat e Njeriut i OKB-së, Rezolutat 9/11 dhe 12/12: E drejta për të ditur të vërtetën, 24 shtator 2008 dhe 12 tetor 2009; shih gjithashtu Raportin e raportuesit special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale ndërsa luftohet terrorizmi, Ben Emmerson, Parimet kryesore për sigurimin e përgjegjësisë së zyrtarëve publikë për shkeljet e rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut në kontekst të iniciativave të shtetit kundër terrorizmit; Dokument i OKB-së A/KDNJ/22/52, 1 mars 2013).

*c) Aplikueshmëria e nenit 2 në kontekstin e Kosovës*

141. Paneli është i vetëdijshëm për faktin se vrasja e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukja e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq ndodhi pak pas vendosjes së UNMIK-ut në Kosovë, menjëherë pas konfliktit të armatosur kur krimi, dhuna dhe pasiguria ishin shumë të përhapura.

142. Për pjesën e tij, PSSP-ja nuk e konteston që UNMIK-u e kishte për detyrë ta hetonte rastin aktual sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Megjithatë, sipas PSSP-së, rrethanat unike të ndërlidhura me kontekstin e Kosovës dhe vendosjen e UNMIK-ut në fazën e parë të misionit, duhet marrë parasysh kur vlerësohet nëse ky hetim është në pajtim me nenin 2 të KEDNJ-së. Në esencë, PSSP-ja argumenton që nuk është e mundshme të vlejnë për UNMIK-un të njëjtat standarde të aplikueshme për një vend në një situatë normale.

143. Paneli konsideron që argumentet e PSSP-së ngritin dy pyetje kryesore: e para, nëse standardet e nenit 2 vazhdojnë të vlejnë në situatën e konfliktit apo dhunës së përgjithësuar dhe, e dyta, nëse standardet e tilla duhet konsideruar plotësisht të aplikueshme për UNMIK-un.

144. Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 2 për UNMIK-un, Paneli rikujton që me miratimin e Rregullores së UNMIKU-t nr. 1999/1, më 25 korrik 1999, UNMIK-u mori përsipër obligimin që t'i zbatojë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut në ushtrimin e funksioneve të veta. Ky zotim u detajua në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/24, të 12 dhjetorit 1999, përmes së cilës UNMIK-u mori përsipër obligimet sipas instrumenteve të caktuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë KEDNJ-në. Në lidhje me këtë, Paneli tanimë ka gjetur se është e vërtetë që karakteri i përkohshëm i UNMIK-ut dhe vështirësitë e ngjashme duhet marrë parasysh në lidhje me një numër situatash, por në asnjë rrethanë këto elemente nuk mund të merren si arsyetim për uljen e standardeve të respektimit të të drejtave të njeriut, të cilat u inkorporuan sipas rregullit në mandatin e UNMIK-ut (shih PKDNJ, *Millogoriq dhe të tjerët*, nr. 38/08 dhe të tjerët, mendimi i 24 marsit 2011, § 44; *Berisha dhe të tjerët*, nr. 27/08 dhe të tjerët, mendimi i 23 shkurtit 2011,§ 25; *Laliq dhe të tjerët*, nr. 09/08 dhe të tjerët, mendimi i 9 qershorit 2012, § 22).

145. Sa i përket aplikueshmërisë së nenit 2 në situatat e konfliktit apo dhunës së përgjithësuar, Paneli rikujton që Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vendosur aplikueshmërinë e nenit 2 në situatat pas konfliktit, duke përfshirë vendet e ish-Jugosllavisë (shih mes shembujve të tjerë, GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës,* përmendur në § 136 më lart dhe GJEDNJ, *Julariq kundër Kroacisë*, nr. 20106/06, vendimi i gjykatës, 20 janar 2011). Gjykata ka konsideruar më tutje që obligimi procedural sipas nenit 2 vazhdon të zbatohet në "kushte të rënda të sigurisë, duke përfshirë një kontekst të konfliktit të armatosur" (shih GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur në § 139 më lart, në § 164; shih gjithashtu GJEDNJ, *Güleq kundër Turqisë*, vendimi i gjykatës, 27 korrik 1998, § 81, Raportet 1998-IV; GJEDNJ, *Ergi kundër Turqisë*, vendimi i gjykatës, 28 korrik 1998, §§ 79 dhe 82, Raportet 1998-IV; GJEDNJ, *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 135 më lart, në §§ 85-90, 309-320 dhe 326-330; *Isayeva kundër Rusisë*, përmendur në § 135 më lart, në §§ 180 dhe 210;

GJEDNJ, *Kanlibaş kundër Turqisë*, nr. 32444/96, vendimi i gjykatës, 8 dhjetor 2005, §§ 39-51).

146. Gjykata ka pranuar që "ku vdekja [dhe zhdukjet] që duhet hetuar sipas nenit 2 ndodhin në rrethana të dhunës së përgjithësuar, konfliktit të armatosur apo kryengritjes, pengesat mund të vendosen në rrugën e hetuesve dhe shtrëngesat konkrete mund të detyrojnë përdorimin e masave më pak efektive të hetimit apo mund të bëjnë që ndonjë hetim të shtyhet" (shih, GJEDNJ [DHL], *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur më lart në §164; GJEDNJ, *Bazorkina kundër Rusisë*, nr. 69481/01, vendimi i gjykatës, 27 korrik 2006, § 121). Megjithatë, gjykata konsideron që "obligimi sipas nenit 2 për të mbrojtur jetën detyron që, madje edhe në kushte të rënda sigurie, të gjithë hapat e arsyeshëm duhet të ndërmerren për të siguruar se po kryhet një hetim efektiv dhe i pavarur për shkeljet e pretenduara të së drejtës për jetë (shih mes shumë shembujve të tjerë, GJEDNJ, *Kaya kundër Turqisë*, përmendur në §133 më lart në §§ 86-92; GJEDNJ, *Ergi kundër Turqisë*, përmendur më lart në §§ 82-85; GJEDNJ [DHL], *Tanrıkulu kundër Turqisë*, nr. 23763/94, vendimi i gjykatës, 8 korrik 1999, §§ 101-110, KEDNJ 1999-IV; GJEDNJ, *Khashiyev dhe Akayeva kundër Rusisë*, nr. 57942/00 dhe 57945/00, vendimi i gjykatës, 24 shkurt 2005, §§ 156-166; GJEDNJ, *Isayeva kundër Rusisë*, përmendur në §135 më lart në §§ 215-224; GJEDNJ, *Musayev dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 57941/00 dhe të tjerët, vendimi i gjykatës, 26 korrik 2007, §§ 158-165).

147. Ngjashëm, KDNJ konsideron që e drejta për jetë, duke përfshirë garancitë e veta procedurale, konsiderohet si e drejtë supreme nga e cila nuk lejohet kurrfarë shmangie, madje edhe në kohën e emergjencave publike të cilat kërcënojnë jetën e kombit (shih, KDNJ, Komenti i përgjithshëm nr. 6, përmendur në § 132 më lart, në § 1; KDNJ, *AbubakarAmirov dhe AïzanAmirova kundër Federatës Ruse*, komunikata nr. 1447/2006, mendimet e 22 prillit 2009, § 11.2, KDCP/C/95/D/1447/2006). Për më tepër, KDNJ ka shpallur aplikueshmërinë e nenit 2 (3), 6 dhe 7 të KNDCP me referencë specifike në obligimin e UNMIK-ut për të kryer hetime të duhura për zhdukjet dhe rrëmbimet në Kosovë (shih KDNJ, Observime përfundimtare të Komitetit për të Drejtat e Njeriut: Kosovë (Serbi), 14 gusht 2006, §§ 12-13, KDCP/C/UNK/CO/1).

148. Paneli vlerëson vështirësitë në të cilat UNMIK-u hasi gjatë fazës së parë të vendosjes së tij. Paneli thekson që rëndësia e duhur kushtuar çështjes së personave të zhdukur në Kosovë, nënkupton që UNMIK-u është dashur t'i marrë parasysh të dyja dimensionet humanitare dhe penale të situatës. Në veçanti, Paneli konsideron se rëndësia që u është kushtuar hetimeve penale dhe vështirësitë në Kosovë që kufizuan aftësinë e autoriteteve hetimore për t'i kryer hetimet e tilla, siç u përshkrua nga PSSP-ja, ishin vendimtare që UNMIK-u të krijojë nga fillimi një ambient të favorshëm për kryerjen e hetimeve kuptimplota. Kjo do të përfshinte krijimin e një sistemi ku do të hynin elementet e tilla, siç janë dhënia e përgjegjësisë së plotë për mbikëqyrjen dhe monitorimin e progresit në hetime, sigurimin e shqyrtimit të rregullt të gjendjes së hetimeve dhe një proces për dorëzim të duhur të rasteve ndërmjet nëpunësve apo njësive të ndryshme të Policisë së UNMIK-ut. Një sistem i tillë gjithashtu duhet marrë parasysh nevojat për mbrojtje të viktimave dhe dëshmitarëve (shih, *mutatismutandis*, GJEDNJ, *R.R. dhe të tjerët kundër Hungarisë*, nr. 19400/11, vendimi i gjykatës, 4 dhjetor 2012, §§ 28-32), dhe gjithashtu të konsiderojë cenueshmërinë e veçantë të personave të zhvendosur në situatat pas konfliktit (shih GJEDNJ [DHL], *Sargsyan kundër Azerbajxhanit*, nr. 40167/06, vendimi i 14 dhjetorit 2011, § 145; dhe GJEDNJ [DHL], *Chiragov dhe të tjerët kundër Armenisë*, nr.

13216/05, vendimi i 14 dhjetorit 2011, § 146). Ndonëse kuptohet që vendosja dhe organizimi i organeve të policisë dhe drejtësisë ndodhi gradualisht, Paneli mendon që ky proces përfundoi në vitin 2003, kur sistemi i policisë dhe gjyqësisë në Kosovë nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së u përshkrua se "funksionon mirë" dhe është "i qëndrueshëm" (shih § 34 më lart).

149. Duke iu përgjigjur vërejtjes së PSSP-së që neni 2 duhet interpretuar në një mënyrë që nuk ngarkon një barrë të papërballueshme dhe joproporcionale mbi autoritetet, në kontekst të aktiviteteve policore apo të prioriteteve dhe burimeve, Paneli e ka parasysh që Gjykata Evropiane ka vendosur që, ajo që arrin të bëhet barrë e papërballueshme dhe/apo joproporcionale, duhet të matet nga faktet dhe kontekstet shumë të veçanta (shih GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur në § 136 më lart, në § 70; *Brecknell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 32457/04, 27 nëntor 2007, § 62).

150. Megjithatë, Paneli konsideron se, në kontekst të krimeve më serioze të kryera kundër popullatës civile, sipas nenit 2 kërkohet që autoritetet t'i bëjnë të gjitha përpjekjet hetimore me qëllim të vërtetimit të fakteve dhe sjelljes së autorëve para drejtësisë. Rasteve të tilla duhet dhënë prioriteti më i lartë.

151. Paneli më tutje tërheq vëmendjen që detyra e tij nuk është t'i shqyrtojë praktikat relevante apo pengesat e pretenduara për të kryer hetime efektive *in abstracto*, por vetëm në lidhje me aplikimin e tyre specifik në rrethana të veçanta të një situate që është çështje para tij (shih GJEDNJ, *Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendimi i gjykatës, 29 nëntor 1988,§ 53, seria A nr. 145-B). Kështu, Paneli pajtohet me PSSP-në, që natyra dhe shkalla e shqyrtimit për të përcaktuar nëse efektiviteti i hetimit e plotëson pragun minimal varet nga rrethanat e rastit të caktuar. Për këto arsye, Paneli konsideron që do të vërtetojë në lidhje me secilin rast nëse janë ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm për të kryer një hetim efektiv siç përshkruhet nga neni 2, duke pasur parasysh realitetet e punës hetimore në Kosovë.

*d) Pajtueshmëria me nenin 2 në rastin aktual*

152. Duke iu kthyer rrethanave të këtij rasti, Paneli thekson që kishte mangësi dhe vonesa në kryerjen e hetimit nga zanafilla e tij, duke pasur parasysh që faza fillestare e hetimit është e një rëndësie shumë të madhe. Megjithatë, në dritë të vlerësimeve të bëra më lart lidhur me juridiksionin e tij të limituar dhe të përkohshëm (shih § 102), Paneli sjell ndërmend që është kompetent *ratione temporis* për të vlerësuar pajtueshmërinë e hetimit me nenin 2 të KEDNJ-së vetëm për periudhën prej 23 prillit 2005, duke pasur parasysh gjendjen e rastit në atë datë (GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur në § 136 më lart në § 70). Periudha në shqyrtim përfundon më 9 dhjetor 2008, me marrjen e përgjegjësisë nga EULEX-i në fushën e administrimit të drejtësisë (shih § 36-37 më lart).

153. Paneli thekson në lidhje me këtë që, sipas Raportit vjetor të vitit 2000 të Policisë së UNMIK-ut, prej 27 tetorit të vitit 1999 Policia e UNMIK-ut i kishte kompetencat e plota ekzekutive në rajonin e Prizrenit, duke përfshirë hetimet penale. Prandaj, ishte përgjegjësi e UNMIK-ut të sigurojë, e para, që hetimi të kryhet në mënyrë ekspeditive dhe efikase; e dyta, që i gjithë materiali relevant hetimor t'i dorëzohet siç duhet autoritetit që merr përgjegjësinë për hetim (EULEX-it, shih §37 më lart); dhe *e treta*, që dosjet hetimore të mund të zbulohen dhe të merren nëse ka nevojë në ndonjë fazë më vonë.

154. Paneli nxjerr përfundim nga mungesa e dosjes së plotë se ka ndodhur një nga situatat vijuese: nuk është kryer kurrfarë hetimi i duhur; dosja nuk i është dorëzuar me saktësi dhe e plotë EULEX-it; apo UNMIK-u ka dështuar ta marrë dosjen e plotë nga kujdestari aktual. Paneli tashmë ka theksuar se nuk ka arsye të dyshojë në qëllimin e mirë të UNMIK-ut për kërkimin dhe sigurimin e dosjes së plotë hetimore për shqyrtimin e tij. Megjithatë, Paneli konsideron se cilido nga këto sqarime potenciale të jetë i zbatueshëm, tregon një dështim, që drejtpërdrejt i atribuohet UNMIK-ut kur ka ushtruar funksionet e veta ekzekutive apo në kapacitetin e tij të tanishëm.

155. Paneli thekson veçanërisht një fakt të rëndësishëm lidhur me këtë rast të veçantë: përgjigjen e EULEX-it në kërkesën e Panelit për informata (shih §§ 92-94 më lart), në të cilën EULEX-i e informoi Panelin se në korrik të vitit 2009 një numër rastesh që nuk i ishin dorëzuar zyrtarisht EULEX-it nga UNMIK-u për arsye të ndryshme ishin "gjetur" në ish-ndërtesën e DD-së së UNMIK-ut. Sipas mendimit të Panelit, ky fakt paraqet veçanërisht indikacion të dështimit të mundshëm të përgjithshëm për të plotësuar obligimin për sigurim të pranim-dorëzimit të duhur të materialit hetimor.

156. Për sa i përket zhdukjes së z. Stanisllav Mitiq dhe znj. Jovanka Mitiq (lëndët nr. 63-66/09 dhe 109/09), Paneli thekson se UNMIK-u u vu në dijeni për çështjen më së voni në tetor të vitit 2001, kur Policia e UNMIK-ut pranoi informatat e tyre ante-mortem nga KNKK-ja. Megjithatë, NJPZH e UNMIK-ut hapi në dosje të rastit për çështjen vetëm dikur në një kohë në vitin 2002.

157. Paneli thekson më tutje se aktiviteti i vetëm i ndërmarrë nga Policia e UNMIK-ut në këtë fazë ishte regjistrimi i informatave ante-mortem në bazën e të dhënave të NJPZH-së të mbledhura më parë nga KNKK-ja. Sipas dosjes hetimore, nuk ishte bërë asnjë përpjekje e vetme, deri në nëntor të vitit 2003, për të kontaktuar T.J., nënën e znj. Jovanka Mitiq dhe dëshmitaren e vetme okulare të ngjarjeve të Mushtishtit, detajet e plota për kontakt të së cilës ishin siguruar nga KNKK-ja në vitin 2001. Paneli gjithashtu thekson se një vonesë e tillë në intervistimin e një dëshmitareje të tillë të moshuar mund të ketë rezultuar me humbjen e dëshmisë së saj të çmueshme. Për më tepër, vetëm në dhjetor të vitit 2004, hetuesit bënë një përpjekje të pasuksesshme për të kontaktuar anëtarët e familjes së viktimës me qëllim të marrjes së informatave tjera.

158. Për sa i përket vrasjes së z. Radisllav Jovanoviq, Paneli thekson se vrasja iu raportua së pari NJQHP-së së UNMIK-ut në dhjetor të vitit 2001. Në këtë kohë, prifti i cili e raportoi incidentin gjithashtu i ofroi Policisë së UNMIK-ut listën e plotë të personave të cilët ishin zhdukur në Mushtisht që nga qershori i vitit 1999 dhe e vuri veten në dispozicion të vendosë një kontakt me dëshmitaren kryesore okulare për rastin, T.J-në. Policia e UNMIK-u e ndërmori veprimin e vet të parë për këtë raportim vetëm dy vjet më vonë, kur deklaratat e dëshmitarit u morën nga prifti dhe T.J., në shtator dhe nëntor të vitit 2003. Rreth kësaj kohe, hetuesit e UNMIK-ut vizituan për herë të parë vendin e pretenduar të krimit dhe morën fotografi të shtëpisë së viktimës (këto fotografi u përmendën gabimisht nga hetuesit e caktuar më pas për rastin si "varg fotografish" të autorëve, shih § 82). Megjithatë, nuk ka asnjë indikacion se hetuesit e kontrolluan si duhet vendin e krimit apo provuan t'i identifikojnë dhe intervistojnë individët me banim në Mushtisht dhe zonat fqinje (p.sh. "lagjen Ramice" e treguar si vendi i njërit nga autorët), të cilit ishin të pranishëm në fshat në kohën e rrëmbimit të pretenduar (sikur fqinjët shqiptarë të cilët e

thirrën KFOR-in me qëllim të mbrojtjes së T.J. në qershor të vitit 1999), dhe të cilët kështu mund të dëshmonin diçka ("kontrolli" i zonës) apo personat (sikur fqinjët shqiptarë të cilët thuhet se i kërkuan KFOR-it ta mbrojë T.J), të cilët do të mund të ofronin informata të tjera mbi pistat e kufizuara hetimore në dispozicion (duke përfshirë emrin dhe mbiemrin e shkruar me ngjyrë të kuqe në shtëpinë e viktimës, apo identitetin e mjekut të fshatit, i cili e kishte vizituar T.J., derisa ishte në mbajtje nga UÇK-ja). Në këtë drejtim, në dosjen hetimore tregohet se rruga e vetme e përdorur nga Policia e UNMIK-ut për të gjurmuar për këtë dëshmitar të mundshëm kryesor ishte të pyesë dy herë priftin A.N., nëse ai e njihte atë.

159. Paneli gjithashtu thekson me shqetësim se, megjithëse NJQHP-ja kishte marrë informata që nga viti 2001 për rreth 20 persona të cilët ishin zhdukur nga vendi i njëjtë dhe në kohën e njëjtë kur ndodhi vrasja e z. Radisllav Jovanoviq, nuk ishte bërë asnjë përpjekje nga hetuesit që t'i vendosin të gjitha këto ngjarje në kontekst dhe të përcaktojnë një strategji për të kryer një hetim të përbashkët dhe sistematik për të gjitha ato krime. Pavarësisht nga këto zbrazëti, rasti ishte mbyllur nga një PN në janar të vitit 2004. Vetëm atëherë, tri vjet pas raportit fillestar për vrasjen, Policia e UNMIK-ut i bëri kërkesë NJPZH-së ta përfshijë z. Radisllav Jovanoviq në listën e tyre të personave të zhdukur dhe t'i rishikojënë bazat e tyre të të dhënave emrat ngalistae personave të zhdukur nga Mushtishti dhe fshatrat fqinje.

160. Paneli gjithashtu thekson se, pavarësisht vlerësimit të prokurorit, hetimi për rastin ishte rishqyrtuar nga NJHKL e UNMIK-ut me një numër tjetër të rastit (shih § 80 më lart) me kërkesën e Qeverisë së Serbisë, në gusht të vitit 2004. Në këtë kohë hetuesit pranuan se mënyra e vetme për të shkuar më tutje me rastin ishte intervistimi i dëshmitares T.J. dhe një rekomandim ishte dhënë për të bërë një intervistë me zë, duke pasur parasysh moshën e saj dhe gjendjen shëndetësore. Në dosje nuk ka dëshmi se kjo ishte bërë.

161. Për sa i përket zhdukjes së z. Stanisllav Markoviq, Paneli thekson se UNMIK-u u vu në dijeni për çështjen më së voni në tetor të vitit 2001, por një dosje për person të zhdukur ishte hapur nga NJPZH-ja vetëm në mars të vitit 2002. Siç është pranuar nga PSSP-ja, nuk është ndërmarrë çfarëdo qoftë veprimi në lidhje me këtë rast, përveç regjistrimit të të dhënave ante-mortem të mbledhura nga KNKK-ja.

162. Për sa i përket zhdukjes së z. Bozhidar Jovanoviq, Paneli thekson se, sipas dosjes hetimore, UNMIK-u ishte në dijeni për çështjen nga dhjetori i vitit 2001, pasi emri i tij ishte përfshirë në listën e personave të zhdukur nga Mushtishti që policisë ia ofroi prifti A.N. Për më tepër, emri i tij ishte gjithashtu i përfshirë në listën e personave të zhdukur që KNKK ia ofroi UNMIK-ut në shkurt të vitit 2002. Megjithatë, nga dosja hetimore duket se rasti i tij ishte regjistruar nga NJPZH-ja vetëm në maj të vitit 2003. Gjithashtu duket se, pas regjistrimit, NJPZH-ja nuk mundi të gjente këtë rast në bazën e të dhënave për arsye të cilat nuk janë sqaruar (shih § 170 më poshtë).

163. Paneli gjithashtu thekson se, nga viti 2001, hetuesit ishin vënë në dijeni se të gjitha viktimat ishin zhdukur në ditët e njëjta gjatë të cilave kishte ndodhur sulm i UÇK-së në fshat dhe me sa duket nga duart e autorëve të njëjtë. Megjithatë në dosjen hetimore tregohet se nuk ishte inicuar asnjë hetim sistematik dhe i koordinuar për këto ngjarje në përpjekje për vendosur lidhje ndërmjet rasteve të ndryshme.

164. Duke u kthyer te periudha nën juridiksionin e tij, nga 23 prilli 2005, Paneli thekson se pas kësaj date kritike vazhdoi dështimi për të kryer veprime të nevojshme hetimore në pajtim me obligimin e vazhdueshëm për të hetuar (shih § 138 më lart), dhe kështu solli deri te vlerësimi për krejt hetimin brenda periudhës së juridiksionit të Panelit.

165. Paneli konsideron se pasi mbetjet mortore të znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Radisllav Jovanoviq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq nuk janë gjetur si dhe ata që janë përgjegjës për krimin nuk janë identifikuar, UNMIK-u ishte i obliguar t'i përdorte mjetet në dispozicion që i ka, për të shqyrtuar rregullisht progresin e hetimit, për të siguruar që asgjë nuk neglizhohet dhe që ndonjë dëshmi e re është marrë parasysh, dhe gjithashtu t'i informojë të afërmit e tyre lidhur me pistat e mundshme dhe të reja të hetimit.

166. Në lidhje me këtë, Paneli thekson se asnjë veprim kuptimplotë nuk ishte ndërmarrë për të shqyrtuar apo hetuar rastet gjatë kësaj periudhe. Për sa i përket zhdukjes së znj. Jovanka Mitiq dhe z. Stanisllav Mitiq, nga dosje hetimore shihet se rasti i tyre ishte shqyrtuar në shtator të vitit 2008. Hetuesi shqyrtues vërejti se deri në atë kohë, pothuaj gjashtë vjet pasi ishte hapur dosja për person të zhdukur, nuk ishin marrë mostra të ADN-së nga anëtarët e familjes së viktimave për qëllime identifikimi. Ai gjithashtu theksoi nuk kishte informata të mjaftueshme mbi identifikimin e personave të zhdukur; megjithatë nuk ishte dhënë asnjë rekomandim apo ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të plotësimit të këtyre zbrazëtive informative.

167. Për sa i përket rastit të z. Radisllav Jovanoviq, Paneli thekson se, në vitin 2004, NJPZH-ja ishte udhëzuar të verifikojë nësekishte ndonjë gjurmë të mbetjeve të tij mortore në vendin e krimit, nën rrënojat e djegura të shtëpisë së tij (shih § 74). Megjithatë, në dosje nuk ka dëshmi se kjo ishte bërë nga NJPZH-ja. Për më tepër, nuk ka asnjë indikacion në dosje të kryerjes dhe regjistrimit me zë (audio) të një interviste tjetër të T.J., dëshmitares së vetme okulare, siç ishte konsideruar e nevojshme kur rasti ishte rihapur nga NJHKL-ja në gusht të vitit 2004 (shih §§ 79-80). Paneli thekson se, kur rasti ishte shqyrtuar herën tjetër më 2007, ai ishte mbyllur duke u bazuar në supozimin se të gjitha pistat e hetimit ishin ndjekur si duhet dhe se T.J. nuk kishte qenë në gjendje të identifikojë vrasësin e djalit të tij në një "varg me fotografi" të sistemuar nga Policia e UNMIK-ut. Paneli thekson me shqetësim mangësinë e këtij shqyrtimi, pasi hetuesi shqyrtues ishte në konfuzion për kompletin e fotografive të marra nga Policia e UNMIK-ut në vitin 2001 në vendin e krimit në Mushtisht (të njohura të tilla nga T.J.), me një varg fotografish të autorëve të mundshëm të krimit, të cilat vërtet me sa duket nuk u bënë kurrë (shih §§ 74 dhe 82 më lart)**.**

168. Në përgjigje të argumentit të PSSP-së se dëshmitarja T.J. nuk i ofroi Policisë informata bindëse lidhur me autorët, identitetin e dëshmitarëve tjerë (mjekun e fshatit), gjetjen e mbetjeve mortore të djalit të saj dhe lidhjen e mundshme me personin, emri i të cilit ishte shkruar në muret e shtëpisë së saj, Paneli thekson se, është normalisht përgjegjësi e autoriteteve hetimore që t'i ndjekin pistat e hetimit dhe t'i vërtetojnë informatat sado të kufizuara të ofruara nga dëshmitarët dhe konsideron se UNMIK-u nuk i ndërmori të gjithë hapat e arsyeshëm në këtë drejtim.

169. Për sa i përket zhdukjes së z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq, Paneli thekson se në periudhën nën juridiksionin e Panelit, nuk është ndërmarrë çfarëdo qoftë veprimi me qëllim të mbledhjes së informatave të mëtejme mbi këto raste dhe nuk është

bërë asnjë përpjekje për t'i gjetur ankuesit apo ndonjë dëshmitarëtjetër të mundshëm, apo për të kuptuar më mirë rrethanat e zhdukjes së tyre.

170. Sa i përket veçanërisht z. Bozhidar Jovanoviq, Paneli tanimë ka theksuar se, pavarësisht faktit se ky rast ishte regjistruar nga NJPZH e UNMIK-ut në vitin 2003, hetuesit e NJPZH-së që kishin për detyrë të gjejnë dosjen me kërkesën e PSSP-së në vitin 2007, nuk mund të gjenin ndonjë regjistrim në lidhje me personin e zhdukur. Duke u bazuar në rezultatet e këtij kërkimi, drejtori i DD-së e këshilloi motrën e viktimës, që në atë kohë jetonte në Serbi, të regjistrojë zhdukjen e vëllait të saj në Zyrën e NJPZH-së në Graçanicë. Rreth të njëjtës kohë, një listë e veprimeve ishte përgatitur nga NJPZH për të mbledhur më shumë informata mbi rastin; megjithatë, nuk ka asnjë indikacion se ndonjë nga këto veprime ishte ndërmarrë ndonjëherë.

171. Paneli thekson më tutje argumentin e PSSP-së se këto raste karakterizoheshin me një "mungesë informatash". PSSP-ja gjithashtu deklaron se nuk u paraqitën dëshmitarë të tjerë dhe nuk u zbulua asnjë dëshmi e re në periudhën nën shqyrtim të Panelit. Në këtë drejtim, Paneli konsideron se qëllimi kryesor i çdo aktiviteti hetimor është gjetja e informatave të nevojshme për të plotësuar zbrazëtitë e një hetimi. Prandaj, mungesa e informatave nuk duhet të shfrytëzohet si argument për të mbrojtur mosveprimin nga autoritetet hetimore. Siç është treguar më lart, në vend të kërkimit aktiv të informatave dhe pistave, Policia e UNMIK-ut thjesht priti që informatat e tjera të dalin vetvetiu.

172. Paneli tanimë ka theksuar se nuk është bërë asnjë përpjekje nga autoritetet hetimore për të hetuar në një mënyrë sistematike dhe të koordinuar zhdukjen e rreth 20 personave nga fshati Mushtisht në qershor të vitit 1999 gjatë një sulmi të bashkërenduar nga UÇK-ja, i cili i duket Panelit të ketë qenë një operacion i pastrimit etnik. Paneli gjithashtu thekson se ky dështim vazhdoi gjatë periudhës nën shqyrtim të Panelit meqë, deri në këtë kohë, nuk duket të jetë vendosur në vend asnjë sistem nga Policia e UNMIK-ut për të krijuar koordinim efektiv ndërmjet njësive të saj të ndryshme dhe për të shmangur përkimin. Në lidhje me këtë, Paneli gjithashtu thekson se nuk ishte bërë asnjë përpjekje nga Policia e UNMIK-ut për të ndjekur linja të qarta hetimi që do të çonin kah grupi i UÇK-së që kontrollonte Mushtishtin dhe fshatrat e afërme, të cilët në deklaratat e dëshmitarëve kishin qenë përgjegjës për krimet kundër banorëve civilë të zonës.

173. Mungesa e qartë e një reagimi të menjëhershëm të Policisë së UNMIK-ut, dhe mungesa e ndonjë veprimi adekuat në fazat e mëvonshme, mund t'u ketë dërguar sinjalin autorëve që, autoritetet ose nuk ishin në gjendje apo nuk ishin të gatshme t'i hetojnë aktet e tilla kriminale. Një qëndrim i tillë i autoriteteve ndaj krimeve më të rënda në ndonjë shoqëri, dhe veçanërisht në rrethanat pas konfliktit, krijon pashmangshëm një kulturë të mosndëshkimit ndër kriminelët dhe mund të çojë vetëm në përkeqësim të situatës. Problemet të cilat UNMIK-u i hasi në fillim të misionit të vet, të cilat u cekën më lart, nuk arsyetojnë mosveprimin e tillë, as në fillim e as më vonë.

174. Paneli është gjithashtu i vetëdijshëm që detyra për të hetuar nuk duhet ndalur së kryeri vetëm për shkak se hetimi nuk ka sjellë rezultate të kënaqshme. Sidoqoftë, një hetim i tillë duhet të ndërmerret seriozisht dhe jo për një formalitet të thjeshtë.

175. Paneli konsideron se, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit të veçantë, nuk janë ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm nga UNMIK-u drejt gjetjes së personave të zhdukur,

identifikimit të autorëve dhe sjelljes së tyre para drejtësisë. Në këtë kuptim, Paneli konsideron se hetimi nuk ishte adekuat dhe në pajtueshmëri me kërkesat për shpejtësi, ekspeditivitet dhe efektivitet (shih § 136 më lart), siç kërkohet me nenin 2.

176. Sa i përket kërkesës për shqyrtim publik, Paneli rikujton që neni 2 gjithashtu kërkon që në të gjitha rastet duhet të jetë i përfshirë në hetim i afërmi i viktimës deri në shkallën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij legjitime.

177. Në lidhje me këtë, Paneli tanimë ka theksuar se dosja hetimore tregon se**,** përveç një përpjekje të vetme të bërë nga Policia e UNMIK-ut për të kontaktuar ankuesen e parë përmes telefonit, nuk ka pasur asnjë kontakt tjetër ndërmjet UNMIK-ut dhe ankuesve në lidhje me hetimin. Prandaj, Paneli konsideron se hetimi nuk ishte i qasshëm për ankuesit siç kërkohet me nenin 2.

178. Në dritë të mungesave dhe mangësive të përshkruara më lart, dhe duke marrë në konsideratë seriozitetin dhe dimensionin e krimeve të kryera dhe gjithashtu dëmin e pësuar nga viktimat dhe familjet e tyre në rastet sikur ky, Paneli konkludon se UNMIK-u dështoi të kryejë hetim efektiv për vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq. Prandaj, është bërë një shkelje e nenit 2 të KEDNJ-së, obligimi procedural.

## B. Shkelja e pretenduar e nenit 3 të KEDNJ-së

179. Paneli konsideron që ankuesit mbështeten, në esencë, në shkeljen e të drejtës për të qenë i lirë nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues, e garantuar sipas nenit 3 të KEDNJ-së.

### 1. Fusha për t'u shqyrtuar nga Paneli

180. Paneli do t'i marrë parasysh pretendimet sipas nenit 3 të KEDNJ-së, duke zbatuar të njëjtën fushë të shqyrtimit, siç është përcaktuar në lidhje me nenin 2 (shih §§97 - 102 më lart).

181. Paneli rikujton që Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka gjetur në shumë raste që një situatë e zhdukjes së imponuar shkakton shkelje të nenit 3 sa u përket të afërmve të ngushtë të viktimës. Ajo thekson që, për sa i përket nenit 3, "esenca e shkeljes së tillë nuk bie aq shumë në faktin e "zhdukjes" së anëtarit të familjes, por më shumë ka të bëjë me reagimet dhe qëndrimet e autoriteteve ndaj situatës kur kjo është sjellë në vëmendjen e tyre" (shih, p.sh. GJEDNJ [DHL], *Çakici kundër Turqisë,* nr. 23657/94, vendimi i gjykatës, 8 korrik 1999, § 98, *KEDNJ*, 1999-IV; GJEDNJ [DHL], *Qiproja kundër Turqisë*, nr. 25781/94, vendimi i gjykatës, 10 maj 2001, § 156, *KEDNJ*, 2001-IV; GJEDNJ, *Orhan kundër Turqisë,* nr. 25656/94, vendimi i gjykatës, 18 qershor 2002, § 358; GJEDNJ, *Bazorkina kundër Rusisë*, përmendur në § 146 më lart, në § 139; GJEDNJ, *Paliq kundër Bosnjë e Hercegovinës*, përmendur në § 136 më lart, në § 74; GJEDNJ, *AlpatuIsrailova kundër Rusisë,* nr. 15438/05, vendimi i gjykatës, 14 mars 2013, § 69; shih gjithashtu PKDNJ, *Zdravkoviq,* nr. 46/08, vendimi i 17 prillit 2009, § 41). "Ka të bëjë veçanërisht me të fundit që një i afërm mund të pohojë të jetë drejtpërdrejt viktimë e sjelljes së autoriteteve" (shih mes tjerash, GJEDNJ, *Er dhe të tjerët kundër Turqisë,* nr. 23016/04, vendimi i gjykatës, 31 korrik 2012, § 94).

182. Në fund, në rast se rrezikohet vuajtja mentale e shkaktuar nga reagimet e autoriteteve ndaj zhdukjes, shkelja e pretenduar është në kundërshtim me elementin esencial të nenit 3 të KEDNJ-së, jo elementin procedural, siç është rasti sa i përket nenit 2 (GJEDNJ, *Gelayevy kundër Rusisë,* nr. 20216/07, vendimi i gjykatës, 15 korrik 2010, §§ 147-148).

**2. Parashtresat e palëve**

183. Për sa i përket vrasjes së z. Radisllav Jovanoviq, ankuesi në lëndën nr. 300/09 në thelb ankohet se, si rezultat i dështimit të UNMIK-ut për të hetuar si duhet rastin dhe ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm me qëllim të gjetjes së mbetjeve mortore të babait të tij dhe kthimit të tyre te familja, atij iu shkaktua vuajtje mentale që paraqet shkelje të nenit 3.

184. Ankuesit gjithashtu në esencë pohojnë që mungesa e informatave dhe sigurisë rreth zhdukjes së anëtarëve të tyre të familjes, veçanërisht për shkak të dështimit të UNMIK-ut që të hetojë si duhet rastin e tyre, u shkaktoi atyre dhe familjeve tyre vuajtje mentale.

185. Për sa i përket nenit 3, PSSP-ja nuk e konteston dhembjen dhe vuajtjen mentale të ankuesve; megjithatë ai argumenton se kjo nuk mund t'i atribuohet UNMIK-ut, por më parë është rezultat i vuajtjes së pandarë të shkaktuar nga zhdukja e një anëtari të ngushtë të familjes dhe faktit fatkeq se deri më tani, pavarësisht përpjekjeve, autoritetet kanë qenë të paafta të përcaktojnë vendndodhjen e personave të zhdukur".

186. Ndërsa pranon se, për sa i përket sjelljes së autoriteteve në përgjigje të pyetjeve nga familja, një shkelje mund të gjendet varësisht nga reagimet dhe qëndrimet e autoriteteve kur situata është sjellë në vëmendjen e tyre, PSSP-ja thekson se nuk ka dokumentacion në dosje që tregon se ankuesit, në periudhën nën shqyrtim të PKDNJ-së, i bënë pyetje NJPZH-së së UNMIK-ut dhe NJKL-së.

187. PSSP-ja thekson se është e qartë nga dosja hetimore se UNMIK-u "mbeti i zënë" me çështjet dhe "ndërmori hetime aktivisht". Nuk ka pasur pohime të bëra nga ankuesit për ndonjë qëllim të keq të personelit të UNMIK-ut, i përfshirë në çështje apo ndonjë qëndrim të UNMIK-ut që do të dëshmonte "mospërfillje të seriozitetit të çështjes apo emocioneve të ankuesve". Prandaj, PSSP-ja argumenton se nuk ka asnjë dokumentacion apo pohim se UNMIK-u veproi në mënyrë jo të duhur apo kishte qëndrim që përbënte shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së.

188. Prandaj, PSSP-ja argumenton se nuk ka pasur shkelje të nenit 3.

**3. Vlerësimi i Panelit**

*a) Parimet e përgjithshme në lidhje me obligimin sipas nenit 3*

189. Sikurse neni 2, edhe neni 3 i KEDNJ-së ruan një nga vlerat më fundamentale në shoqëritë demokratike (GJEDNJ, *Talat Tepe kundër Turqisë,* nr. 31247/96, 21 dhjetor 2004, § 47; GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë,* nr. 48787/99, vendimi i gjykatës, 8 korrik 2004, *KEDNJ*, 2004-VII, § 424). Siç konfirmohet nga natyra absolute e dhënë për të me nenin 15 § 2 të KEDNJ-së, ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor dhe degradues vlen, madje në rrethanat më të vështira.

190. Duke përcaktuar parimet e përgjithshme të aplikueshme në situatat ku pretendohen shkeljet e obligimit sipas nenit 3 të KEDNJ-së, Paneli thekson që fenomeni i zhdukjes përbën një formë komplekse të shkeljes së të drejtave të njeriut, që duhet kuptuar dhe konfrontuar në një mënyrë integrale (shih GJNADNJ, *Velásquez-Rodríguez kundër Hondurasit*, përmendur në § 132 më lart, në § 150).

191. Paneli thekson që obligimi sipas nenit 3 të KEDNJ-së dallon nga obligimi procedural mbi autoritetet sipas nenit 2. Ndërsa i fundit kërkon nga autoritetet të ndërmarrin veprim specifik ligjor që është në gjendje të çojë kah identifikimi dhe dënimi i atyre që janë përgjegjës, i pari është më i përgjithshëm dhe humanitar dhe lidhet me reagimin e tyre ndaj gjendjes së vështirë të të afërmve të atyre që janë zhdukur apo kanë vdekur.

192. KDNJ-a gjithashtu ka pranuar zhdukjet si shkelje serioze e të drejtave të njeriut. Në vendimin e tij të 21 korrikut 1983, në rastin *Quinteros kundër Uruguait*, ai shpall që zhdukjet përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të të afërmve të personit të zhdukur, të cilët vuajnë nga një shqetësim i thellë, i cili vazhdon për aq kohë sa zgjat pasiguria lidhur me fatin e të dashurve të tyre, shpeshherë për shumë vjet (shih KDNJ, komunikata nr. 107/1981, Dok. i OKB-së KDCP/C/OP/2 në 138 (1990), § 14). Për më tepër, në vendimin e vet të 15 korrikut 1994, në rastin *Mojica kundër Republikës Dominikane*, KDNJ ka gjykuar që "zhdukja e personave është pandashëm e lidhur me trajtimin që arrin në shkelje të nenit 7 [të Konventës]", që gjithashtu ndalon torturën dhe trajtimin dhe dënimin jonjerëzor dhe degradues (shih KDNJ, komunikata nr. 449/1991, Dok. i OKB-së, KDCP/C/51/D/449/1991 (1994), § 5.7).

193. Sa i përket pyetjes, nëse një anëtar i familjes së personit të zhdukur mund të konsiderohet viktimë e trajtimit në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës së vet gjyqësore. Gjykata Evropiane pranon që ky mund të jetë rasti, varësisht nga ekzistenca e "faktorëve të veçantë, të cilët i japin vuajtjes [së anëtarit të familjes] një dimension dhe karakter të ndryshëm nga shqetësimi emocional që vlerësohet se u është shkaktuar pashmangshëm të afërmve të viktimës nga një shkelje serioze e të drejtave të njeriut". Gjykata më tutje konsideron që "elementet relevante do të përfshijnë afërsinë e lidhjes familjare, rrethanat e veçanta të marrëdhënies, shkalla deri në të cilën anëtari i familjes dëshmoi ngjarjet në fjalë, përfshirjen e anëtarit të familjes në përpjekjet për të marrë informata mbi personin e zhdukur dhe mënyra me të cilën autoritetet iu përgjigjën këtyre kërkimeve" (shih GJEDNJ, *Basayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 15441/05 dhe 20731/04, vendimi i gjykatës, **29** maj 2009, § 159; GJEDNJ, *Er dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur në § 181 më lart, në § 94).

194. Paneli thekson që, kur vlerësohet vuajta emocionale e viktimave, Gjykata Evropiane gjithashtu merr parasysh rrethanat vijuese: kohëzgjatjen e zhdukjes dhe periudhën pa informata mbi fatin e personit të zhdukur dhe hetimin e zhvilluar nga autoritetet; vonesën në nisjen e hetimit penal për zhdukjen; mungesën e ndonjë veprimi "kuptimplotë" nga autoritetet, pavarësisht nga fakti që ankuesit iu janë drejtuar atyre për të raportuar zhdukjen e të afërmve të tyre dhe të ndajnë me ata informatat që i kanë pasur; mungesa e ndonjë sqarimi apo informate bindëse për fatin e të afërmve të tyre të zhdukur, pavarësisht pyetjeve personale dhe atyre me shkrim për organet zyrtare (shih mes tjerash, GJEDNJ, *Er dhe të tjerët kundër Turqisë*, përmendur më lart, në § 96; GJEDNJ, *Osmanoğlu kundër Turqisë*, nr. 48804/99, vendimi i gjykatës, 24 janar 2008, § 97). Faktor tjetër që çon kah

konkluzioni për një shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së, është natyra e vazhdueshme e vuajtjes psikologjike të të afërmve të një viktime të zhdukur (GJEDNJ, *Salakhov dhe Islyamova kundër Ukrainës*, nr. 28005/08, vendimi i gjykatës, 14 mars 2013, § 201).

195. Gjykata në mënyrë të veçantë ka gjetur shkelje të nenit 3 gjithashtu në ato raste, duke përfshirë vrasjet e çastit, ku nuk ka pasur periudhë të dallueshme që ka zgjatur shumë gjatë së cilës të afërmit kishin pasiguri, vuajtje dhe dhimbje karakteristike për fenomenin e zhdukjeve por ku kufomat e viktimave janë "copëtuar apo u është prerë koka dhe ku parashtruesit nuk kanë pasur mundësi të varrosin trupat e vdekur të të dashurve të tyre në një mënyrë të duhur, e cila, sipas Gjykatës, "mund t'u ketë shkaktuar atyre vetvetiu dhimbje dhe vuajtje të thellë dhe të vazhdueshme". Gjykata, në këtë mënyrë, konsideroi se "në rrethanat specifike të rasteve të tilla, vuajtja morale e përjetuar nga parashtruesit ka arritur një dimension dhe karakter i ndryshëm nga shqetësimi emocional që vlerësohet se i shkaktohet paevitueshëm një viktime nga një shkelje serioze e të drejtave të njeriut" (shih, GJEDNJ, *M. dhe të tjerët kundër Italisë dhe Bullgarisë*, nr. 40020/03, vendimi i gjykatës, 31 korrik 2012,§ 75; GJEDNJ, *Khadzhialiyev dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 3013/04, vendimi i gjykatës, 6 nëntor 2008 § 121; dhe GJEDNJ,*Akpınar dhe Altun kundër Turqisë*, nr. 56760/00, § 86, 27 shkurt 2007).

196. KDNJ gjithashtu ka konsideruar çështjen dhe ka njohur anëtarët e familjes së personave të zhdukur apo të pagjetur si viktima nga shkelja e nenit 7 të Konventës: prindërit (*Boucherf kundër Algjerisë*, komunikata nr. 1196/2003, mendimet e 30 marsit 2006, § 9.7, KDCP/C/86/D/1196/2003), fëmijët (*Zarzi kundër Algjerisë*, komunikata nr. 1780/2008, mendimet e 22 marsit 2011, § 7.6, KDCP/C/101/D/1780/2008), vëllezërit dhe motrat (*El Abani kundër Xhamahirisë Arabe të Libisë*, komunikata nr. 1640/2007, mendimet e 26 korrikut 2010, § 7.5, KDCP/C/99/D/1640/2007), bashkëshortët (*Bousroual kundër Algjerisë*, komunikata nr. 992/2001, mendimet e 30 marsit 2006, § 9.8, KDCP/C/86/D/992/2001), tezet (hallat) dhe dajat (axhët) (*Benaniza kundër Algjerisë*, mendimet e 26 korrikut 2010, § 9.4, KDCP/C/99/D/1588/2007) (*Bashasha kundër Xhamahirisë Arabe të Libisë*, mendimet e 20 tetorit 2010, në § 7.2, KDCP/C/100/D/1776/2008). Ai arsyeton këtë kuptim të gjerë për gjendjen e viktimës nga vuajtja dhe shqetësimi që u shkaktohen anëtarëve të familjes me zhdukjen e një individi, e cila gjendje shpeshherë është rënduar nga përpjekjet e pamjaftueshme të autoriteteve për të hetuar zhdukjen me qëllim të vërtetimit të fatit të viktimës dhe sjelljes së autorëve para drejtësisë (*Aboussedra kundër Xhamahirisë Arabe të Libisë*, komunikata nr. 1751/2008, mendimet e 25 tetorit 2010, § 7.5, KDCP/C/100/D/1751/2008). Në rastin *Amirov kundër Federatës Ruse*, Komisioni thekson që "[p]a dashur të sqarohen të gjitha rrethanat e viktimizimit indirekt, Komisioni konsideron që dështimi për përgjegjësi nga ana e shtetit për t'i kryer obligimet e veta, për t'i hetuar dhe qartësuar rrethanat e dëmit të vuajtur nga viktima direkte, do të jetë zakonisht një faktor. Faktorët shtesë mund të jenë të nevojshëm. Në rastin aktual, Komisioni thekson që kushtet e tmerrshme në të cilat autori erdhi për të gjetur mbetjet e gjymtuara të gruas së tij (…), të përcjella nga masat e ngadalshme, sporadike të marra për të hetuar rrethanat, kanë çuar te gjetjet e mësipërme të shkeljes së neneve 6 dhe 7, të shpallura së bashku me nenin 2, paragrafi 3. Komisioni konsideron që, marrë së bashku, rrethanat e detyrojnë Komisionin të konkludojë që të drejtat e autorit sipas nenit 7 gjithashtu janë shkelur" (shih KDNJ, *Amirov kundër Federatës Ruse*, përmendur në § 147 më lart, në § 11.7).

197. Paneli gjithashtu e merr parasysh që sipas Gjykatës Evropiane, analiza e reagimit të autoriteteve nuk duhet të kufizohet në ndonjë manifestim specifik të qëndrimeve të autoriteteve, incidente të izoluara apo akte procedurale; përkundrazi, sipas mendimit të gjykatës, vlerësimi i mënyrës me të cilën autoritetet e shtetit të paditur iu përgjigjen pyetjeve të parashtruesve duhet të jetë i përgjithshëm dhe i vazhdueshëm " (shih GJEDNJ, *Açiş kundër Turqisë,* nr. 7050/05, vendimi i gjykatës, 1 shkurt 2011, § 45).

198. Në lidhje me këtë, është qëndrim i Gjykatës Evropiane që të gjeturat sipas obligimit procedural të nenit 2, do të ishin gjithashtu të një rëndësie të drejtpërdrejtë për të konsideruar ekzistencën e shkeljes së nenit 3 (shih GJEDNJ, *Basayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur në § 193 më lart, në § 109; GJEDNJ, *Gelayevy kundër Rusisë,* nr. 20216/07, vendimi i gjykatës, 15 korrik 2010, § 147; GJEDNJ, *Bazorkina kundër Rusisë*, përmendur në § 146 më lart, në § 140).

199. Paneli thekson që Gjykata Evropiane tashmë ka gjetur shkeljet e nenit 3 të KEDNJ-së në lidhje me zhdukjet, në të cilat shteti u gjet të jetë përgjegjës për rrëmbimet (shih GJEDNJ, *Luluyev dhe të tjerët kundër Rusisë,* nr. 69480/01, vendimi i gjykatës, 9 nëntor 2006, §§ 117-118; GJEDNJ, *Kukayev kundër Rusisë,* nr. 29361/02, vendimi i gjykatës, 15 nëntor 2007, §§ 107-110). Megjithatë, në kontrast, në rastin në shqyrtim të Panelit, UNMIK-u nuk është i implikuar në asnjë mënyrë në zhdukjen aktuale dhe UNMIK-u nuk mund të jetë përgjegjës për shqetësimin mental të parashtruesve, të shkaktuar nga kryerja e krimit.

200. Paneli është i vetëdijshëm që në mungesë të gjetjes së përgjegjësisë së shtetit për zhdukje, Gjykata Evropiane ka vendosur se nuk është bindur që sjellja e autoriteteve, megjithëse neglizhente deri në shkallën që e ka shkelur nenin 2 në aspektin e vet procedural, mund t'i ketë shkaktuar vetvetiu shqetësim mental parashtruesit, më shumë sesa niveli minimal i ashpërsisë, i cili është i nevojshëm me qëllim që të konsiderohet që trajtimi bie brenda fushës së nenit 3 (shih në mes tjerash, GJEDNJ, *Tovsultanova kundër Rusisë*, nr. 26974/06, vendimi i gjykatës, 17 qershor 2010, § 104; GJEDNJ, *Shafiyeva kundër Rusisë*, nr. 49379/09, vendimi i gjykatës, 3 maj 2012, § 103).

*b) Aplikueshmëria e nenit 3 në kontekstin e Kosovës*

201. Sa i përket aplikueshmërisë së standardeve të lartpërmendura në kontekstin e Kosovës, Paneli së pari i referohet qëndrimit të tij mbi të njëjtën çështje në lidhje me nenin 2, të paraqitur më lart (shih §§ 141 – 151 më lart).

202. Paneli rithekson që një sistem për zbatimin e ligjit që funksionon normalisht duhet t'i marrë parasysh nevojat për mbrojtje të viktimave dhe dëshmitarëve dhe gjithashtu të konsiderojë cenueshmërinë e veçantë të personave të zhvendosur në situatat pas konfliktit. Paneli tashmë ka marrë parasysh faktin që deri në vitin 2003, sistemi i policisë dhe drejtësisë në Kosovë nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së është përshkruar që të jetë, si sistem që "funksionon mirë" dhe "i qëndrueshëm" (shih §34 më lart).

203. Paneli përsëri tërheq vëmendjen që nuk do t'i shqyrtojë praktikat relevante apo pengesat e pretenduara për kryerjen e hetimeve efektive *in abstracto*, por vetëm në lidhje me aplikimin e tyre specifik në ankesën para tij, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të rastit.

204. Për këto arsye, Paneli konsideron që duhet të verifikojë për çdo rast, nëse qëndrimi dhe reagimet e autoriteteve të UNMIK-ut për zhdukjen dhe kërkimin e informatave nga ankuesit në lidhje me fatin e të afërmve të tyre dhe hetimin penal, arrin deri në një shkelje të obligimit sipas nenit 3, duke pasur parasysh realitetet në Kosovë në kohën relevante.

*c) Pajtueshmëria me nenin 3 në rastin aktual*

205. Në këto rrethana, Paneli dallon një numër të faktorëve në rastin aktual të cilët, marrë së bashku, ngritin pyetjen e shkeljes së nenit 3 të KEDNJ-së.

206. Paneli thekson afërsinë e lidhjeve familjare ndërmjet ankuesve dhe viktimave në këto raste. Ankuesit janë djemtë dhe vajzat apo gratë e viktimave.

207. Paneli thekson më tutje se duket se ankuesit nuk ishin kontaktuar kurrë drejtpërdrejtë nga autoritetet e UNMIK-ut gjatë hetimit, duke përfshirë qëllimin e mbledhjes së informatave të mëtejme mbi rrëmbimin apo ofrimit të informatave të azhurnuara mbi hetimin.

208. Në fillim, për sa i përket vrasjes së z. Radisllav Jovanoviq (lënda nr. 300/09), Paneli rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikën e vet gjyqësore se aplikimi i nenit 3 përgjithësisht nuk zgjerohet te të afërmit e një personi i cili është vrarë në rastin e vdekjes së çastit (shih GJEDNJ,*Bitiyeva dhe X kundër Rusisë*, nr. 57953/00 dhe 37392/03, vendimi i gjykatës, 21 qershor 2007, § 152; GJEDNJ, *Udayeva dhe Yusupova kundër Rusisë*, nr. 36542/05, vendimi i gjykatës, 21 dhjetor 2010, § 82; shih gjithashtu PKDNJ, *Filipoviq*, lënda nr. 92/09, vendimi i 11 gushtit të vitit 2011, në §§ 21-22). Paneli thekson se rasti i çastit dallohet në atë që, pavarësisht dëshmisë së dëshmitares okulare T.J. se z. Radisllav Jovanoviq ishte vrarë, mbetjet e tij mortore kurrë nuk ishin gjetur dhe, për këtë arsye, ai akoma raportohet si i zhdukur nga KNKK dhe KNPZH**.**

209. Paneli tanimë ka theksuar dështimin e UNMIK-ut për të kryer hetim efektiv për këtë rast sipas nenit 2 të KEDNJ-së. Në veçanti, Paneli ka theksuar se, pas regjistrimit të Radisllav Jovanoviç si i zhdukur, NJPZH e UNMIK-ut kurrë nuk e përcolli tutje kërkesën e T.J. dhe hetuesit (shih § 74) për të verifikuar nëse mbetjet mortore të z. Radisllav Jovanoviq ishin akoma në shtëpi ku thuhet se ai ishte vrarë dhe djegur. Në kontekst të nenit 3, Paneli konsideron se, për shkak të mosveprimit të UNMIK-ut, ankuesi dhe familja e tij janë lënë në një situatë pasigurie lidhur me vendndodhjen e mbetjeve mortore të z. Radisllav Stojanoviq dhe ishin privuar për disa vitenga mundësia e ofrimit atij një varrim të dinjitetshëm. Kështu, Paneli konsideron në rrethanat specifike të këtij rasti, duke pasur parasysh moshën e shtyrë të nënës së viktimës, se vuajtja e pësuar nga ankuesi dhe familja e tij ka pasur një dimension dhe karakter të ndryshëm nga shqetësimi emocional i cili vlerësohet se u shkaktohet paevitueshëm të afërmve nga një shkelje serioze e të drejtave të njeriut, që arrin në shkelje të nenit 3 (shih GJEDNJ, *Khadzhialiyev dhe të tjerët kundër Rusisë*, përmendur në § 195 më lart, § 121).

210. Paneli gjithashtu thekson reagimin e UNMIK-ut në informatën se T.J., gjyshja e ankuesve në lëndën nr. 63-66-09 dhe 109/09, kishte qenë dëshmitare okulare e disave nga ngjarjet. Megjithëse kjo informatë kishte arritur te Policia e UNMIK-ut që nga dhjetori i vitit 2001, dëshmitarja ishte kontaktuar vetëm në nëntor të vitit 2003. Për sa i përket lëndës nr. 300/09, Paneli thekson se ankuesi, z. Todor Markoviq, paraqiti një kallëzim penal te PN

lidhur me zhdukjen e babait të tij dhe se në dosje nuk tregohet asnjë dëshmi se ishte vepruar në këtë drejtim. Paneli gjithashtu thekson përgjigjen e UNMIK-ut në letrën e shkruar nga motra e z. Bozhidar Jovanoviq (lënda nr. 301/09) për PSSP-në në vitin 2007. Në këtë letër, DD-ja gabimisht e informoi ankuesen se rasti kurrë nuk ishte regjistruar nga NJPZH dhe e ftoi atë, një person të zhvendosur së brendshmi që jeton në Serbi, të shkojë në Zyrën e NJPZH-së në Graçanicë për ta bërë këtë. Paneli rithekson që nga këndvështrimi i nenit 3 mund t'i shqyrtojë reagimet dhe qëndrimet e UNMIK-ut ndaj ankuesit në tërësinë e vet.

211. Duke nxjerrë konkluzione nga dështimi i UNMIK-ut që të japë sqarim bindës për mungesën e kontaktit të rregullt dhe të pandërprerë me ankuesit, Paneli konsideron që kjo situatë, e cila vazhdoi në periudhën e juridiksionit të përkohshëm të Panelit, u shkaktoi pasiguri të madhe ankuesve dhe familjeve të tyre për fatin e anëtarëve të familjeve të tyre dhe gjendjen e hetimit. Për sa i përket argumentimit të PSSP-së se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 duke pasur parasysh se nuk ka asnjë dokumentacion që ankuesit i kanë bërë pyetje Policisë së UNMIK-ut në periudhën nën juridiksionin e Panelit, Panelit i duketjo plotësisht e duhur, në rrethanat e rastit siç është përshkruar më lart, për t'ia atribuuar absolutisht dështimin për çdo kontakt familjeve të viktimave.

212. Duke pasur parasysh këtë që u tha më lart, Paneli konkludon që ankuesit përjetuan shqetësim të rëndë dhe dhimbje për një periudhë kohore të zgjatur dhe të vazhdueshme, nga mënyra se si autoritetet e UNMIK-ut e kanë trajtuar rastin dhe si rezultat pamundësisë së tyre për të zbuluar se çfarë i ka ndodhur znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq dhe për të gjetur mbetjet mortore të z. Radisllav Jovanoviq. Në lidhje me këtë, është e qartë që, në çdo situatë, dhimbja e një familje e cila duhet të jetojë në pasiguri rreth fatit të anëtarit të ngushtë të familjes është e padurueshme.

213. Për arsyet e përmendura më lart, Paneli përfundon që, me sjelljen e vet, UNMIK-u i ka kontribuar shqetësimit dhe vuajtjes mentale të ankuesve, duke shkelur nenin 3 të KEDNJ-së.

## V. KOMENTE DHE REKOMANDIME PËRFUNDIMTARE

214. Në dritën e gjetjeve të Panelit në këtë rast, Paneli mendon se është e nevojshme ndonjë formë e dëmshpërblimit.

215. Paneli thekson që zhdukjet e imponuara dhe ekzekutimet arbitrare përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut, të cilat do të hetohen dhe ndiqen në të gjitha rrethanat. Paneli gjithashtu thekson që UNMIK-u si administrues territorial i Kosovës nga viti 1999 deri më 2008, kishte përgjegjësinë primare që t'i hetojë në mënyrë efektive dhe t'i ndjekë ata që ishin përgjegjës për vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq, dhe se dështimi i tij për ta bërë këtë, paraqet shkelje të mëtejme serioze të të drejtave të viktimave dhe më të afërmve, në veçanti të së drejtës për ta ditur të vërtetën për çështjen.

216. Paneli thekson shqetësimet e PSSP-së që burimet joadekuate, veçanërisht në fillim të misionit të UNMIK-ut, e bën të vështirë arritjen e përmbushjes së obligimeve të UNMIK-ut për të drejtat e njeriut.

217. Do të ishte normale që UNMIK-u t'i marrë masat e duhura me qëllim që t'i ndalë shkeljet e gjetura dhe t'i korrigjojë aq sa është e mundshme efektet nga kjo. Megjithatë, siç ka theksuar Paneli më lart (shih § 36), përgjegjësia e UNMIK-ut në lidhje me administrimin e drejtësisë në Kosovë përfundoi më 9 dhjetor 2008, me marrjen përsipër nga EULEX-i të kontrollit të plotë operacional në fushën e zbatimit të ligjit. Prandaj, UNMIK-u nuk është më në pozitë të marrë masa që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në hetime që ende janë në zhvillim e sipër para EULEX-it apo autoriteteve lokale. Gjithashtu, pas shpalljes së pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të Kosovës, më 17 shkurt 2008, dhe më pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008, UNMIK-u ndaloi kryerjen e funksioneve ekzekutive në Kosovë, dhe ky fakt kufizoi aftësinë e tij për të siguruar korrigjim të plotë dhe efektiv të shkeljeve të kryera, siç kërkohet me parimet e vendosura në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

218. Paneli konsideron se kjo situatë faktike nuk e liron UNMIK-un nga obligimi i tij për t'i korrigjuar aq sa është e mundshme efektet e shkeljeve për të cilat është përgjegjës.

**Për sa i përket ankuesve dhe rasteve Paneli konsideron se është e nevojshme që UNMIK-u:**

- Në pajtim me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në situatat me juridiksion të kufizuar të shtetit (shih GJEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, nr. 48787/99, vendimi i gjykatës, 8 korrik 2004, *KEDNJ*, 2004-VII, § 333; GJEDNJ, *Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 61498/08, vendimi i gjykatës, 2 mars 2010, § 171; GJEDNJ (DHL), *Catan dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë,* nr. 43370/04, 8252/05 dhe 18454/06, vendimi i gjykatës, 19 tetor 2012, § 109), duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet diplomatike në dispozicion të tij *vis-à-vis* EULEX-it dhe autoriteteve të Kosovës, të marrë siguri që hetimet në lidhje me rastin në fjalë do të vazhdojnë në pajtueshmëri me kërkesat për një hetim efektiv siç parashihet me nenin 2, që rrethanat që kanë sjellë deri te vrasja e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukja e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq, do të tregohen dhe që autorët do të sillen para drejtësisë. Ankuesit dhe/apo më të afërmit, do të informohen për veprimet e tilla dhe dokumentet relevante do t'u zbulohen atyre sipas nevojës;

- Të pranojë publikisht, brenda një kohe të arsyeshme, përgjegjësinë për sa i përket dështimit të UNMIK-ut që të hetojë në mënyrë adekuate vrasjen e z. Radisllav Jovanoviq dhe zhdukjen e znj. Jovanka Mitiq, z. Stanisllav Mitiq, z. Stanisllav Markoviq dhe z. Bozhidar Jovanoviq, dhe gjithashtu për shqetësimin dhe vuajtjen mentale të shkaktuar më vonë dhe t'u kërkojë falje publike ankuesve dhe familjeve të tyre për këtë;

- Të ndërmarrë hapa të duhur për pagesën e kompensimit adekuat për ankuesit, për dëmin e shkaktuar moral për shkak të dështimit të UNMIK-ut që të kryejë hetim efektiv dhe gjithashtu për shqetësimin dhe vuajtjen mentale të shkaktuar më vonë ankuesve si pasojë e sjelljes së UNMIK-ut.

**Paneli gjithashtu e konsideron të nevojshme që UNMIK-u:**

- Në pajtim me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së mbi "Parimet Bazë dhe Udhëzimet mbi të Drejtën për Kompensim dhe Dëmshpërblim për Viktimat për arsye të Shkeljeve të Mëdha të së Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe Shkeljeve Serioze të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare" (A/Rez/60/147, 21 mars 2006), të ndërmarrë hapa të nevojshëm, përmes organizmave të tjerë të afërt me OKB-në që veprojnë në Kosovë, organeve lokale dhe organizatave joqeveritare, për krijimin e një programi të plotë dhe gjithëpërfshirës dëmshpërblimi, duke përfshirë kthimin e kompensimit, rehabilitimin, përmbushjen dhe garancitë për mospërsëritje për viktimat nga të gjitha komunitetet që kanë qenë subjekt i shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut, të cilat ndodhën si pasojë e drejtpërdrejtë e konfliktit të Kosovës dhe gjatë tij;

- Të ndërmarrë hapa të nevojshëm para organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, që të ndajë burime adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar që standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mbështeten në çdo kohë nga OKB-ja, duke përfshirë kohën kur kryhen funksione administrative dhe ekzekutive mbi një territor, dhe të sigurojë monitorim efektiv dhe të pavarur;

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli, unanimisht,

1. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË OBLIGIMIT PROCEDURAL SIPAS NENIT 2 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

2. **KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË OBLIGIMIT ESENCIAL SIPAS NENIT 3 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

3. **REKOMANDON QË UNMIK-u:**

   a. **T'U KËRKOJË EULEX-it DHE AUTORITETEVE TË TJERA KOMPETENTE NË KOSOVË QË T'I NDËRMARRIN TË GJITHË HAPAT E MUNDSHËM ME QËLLIM TË SIGURIMIT QË HETIMI PENAL PËR VRASJEN E Z. RADISLLAV JOVANOVIQ DHE ZHDUKJEN E ZNJ. JOVANKA MITIQ, Z. STANISLLAV MITIQ, Z. STANISLLAV MARKOVIQ DHE Z. BOZHIDAR JOVANOVIQ DO TË VAZHDOJË NË PAJTIM ME NENIN 2 TË KEDNJ-së DHE QË AUTORËT TË SILLEN PARA DREJTËSISË;**

   b. **TË PRANOJË PUBLIKISHT PËRGJEGJËSINË PËR DËSHTIMIN E VET QË TË KRYEJË HETIM EFEKTIV PËR VRASJEN E Z. RADISLLAV JOVANOVIQ DHE ZHDUKJEN E ZNJ. JOVANKA MITIQ, Z. STANISLLAV MITIQ, Z. STANISLLAV MARKOVIQ DHE Z. BOZHIDAR JOVANOVIQ, DHE GJITHASHTU PËR SHQETËSIMIN DHE VUAJTJET MENTALE TË SHKAKTUARA DHE T'U KËRKOJË FALJE PUBLIKE ANKUESVE;**

**c. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR DREJT PAGESËS SË KOMPENSIMIT ADEKUAT ANKUESVE PËR DËMIN MORAL NË LIDHJE ME GJETJEN E SHKELJEVE TË NENIT 2 DHE 3 TË KEDNJ-së.**

**d. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR PËR TË KRIJUAR NJË PROGRAM TË PLOTË DHE GJITHËPËRFSHIRËS DËMSHPËRBLIMI;**

**e. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR NË KOMBET E BASHKUARA SI NJË GARANCI PËR MOSPËRSËRITJE;**

**f. TË MARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIT DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.**

Andrey Antonov
Zyrtar ekzekutiv

Marek Nowicki
Kryesues

*Shtojca*

## SHKURTESAT DHE AKRONIMET

**CCIU** – Njësiti Qendror për Hetim Penal
**CCPR –** Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
**DOJ** – Departamenti i Drejtësisë
**DPPO** – Zyra e Qarkut e prokurorit publik
**ECHR** – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
**ECtHR-** Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
**EU** – Bashkimi Evropian
**EULEX** – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
**FRY** – Republika Federale e Jugosllavisë
**HRAP** – Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
**HRC** – Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
**IACtHR**– Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut
**ICMP** – Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur
**ICRC** – Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
**ICTY** – Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi
**IP-** Prokuror ndërkombëtar
**KFOR** – Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
**KLA** – Ushtria Çlirimtare e Kosovës
**MPU** – Njësiti për Persona të Zhdukur
**NATO** – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
**OMPF** – Zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore
**OSCE** – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
**RIU** – Njësiti Rajonal për Hetim
**SRSG** – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
**UN** – Kombet e Bashkuara
**UNHCR** – Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
**UNMIK** – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
**VRIC** – Komisioni për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave
**WCIU** – Njësiti për Hetim të Krimeve të Luftës